EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5986
E hënë, 27 janar 2020
çmimi 0.40 €

## Rritet numri i rezonancave magnetike dhe i shërbimeve radiologjike

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

20 VJET ME GAZETËN E PËRDITSHME "EPOKA E RE" FAQE 4, 5, 6,7

# DY DEKADA 'EPOKA E RE'

Gazeta "Epoka e re" ka shënuar 20-vjetorin e themelimit. Në këto dy dekada gazeta ka pasur edhe sfida, disa të rënda e disa të lehta, por deri më sot i ka kaluar të gjitha me sukses. Sot, për këtë moshë të saj, kanë uruar personalitete të jetës politike, arsimore, shkencore, kulturore dhe lexuesit e saj fanatikë. Në këtë përvjetor jubile botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka falënderuar kolegët dhe gazetarët e tanishëm si dhe qindra mijëra lexues të çmuar të gazetës dhe miqtë përkrahës të saj. Ai ka thënë se janë hapur e mbyllur rreth 15 gazeta të përditshme por, sipas tij, të ecësh fikall vetëm, për fije të perit, dhe të thuash ende botojmë një gazetë të shtypur, nuk është tregim aq i vogël në Kosovë



## OPINION

### "EPOKA E RE", GAZETA MË PRESTIGJIOZE PAS UÇK-së

F. 06

Nga: Ismet SYLEJMANI



### GAZETË ME PËRGJEGJËSI PROFESIONALE DHE SHTETNDËRTUESE

F. 07

Nga: Ismet RASHITI, publicist



## EKONOMI

### 420 MILIONË EURO TË HYRA NGA AKCIZA

F. 9

### TRANSPORTI I 'IZOLUAR' HEKURUDHOR I KOSOVËS

F. 9

KJO JAVË PRITET TË JETË KYÇE PËR MUNDËSINË E ARRITJES SË KOALICIONIT QEVERISËS NË MES TË LËVIZJES VETËVENDOSJE (LV) DHE LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK)



# Lutfi Haziri e përsërit: LDK-ja do balancim të pushtetit

Pavarësisht se kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, pati thënë se deri në fund të javës që lamë pas do të dalin me një konstatim se do të bëhet ose jo marrëveshja me Lëvizjen Vetëvendosje, asnjë lëvizje në këtë drejtim nuk ka pasur të dielën, përveç deklaratës së nënkryetarit të LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se një ndarje e drejtë dhe e balancuar e pushtetit mbi parimet e mirëbesimit do të bënte që programi qeverisës, me LV-në udhëheqëse të qeverisë e LDK-në udhëheqëse të Kuvendit, do t'i jepnin fuqi koalicionit

FAQE 3

## KULTURË



### PIKËPAMJET E PROFESOR REXHEP QOSJES PËR ALBANOLOGJINË

F. 13

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

### PËRMASA MË SHUMË SE PERSONALE TË NJË RRËFIMI TË SINQERTË

F. 06

Jakup KRASNIQI



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## KE-ja mban mbledhjen e parë për këtë vit, diskutohet edhe për Shqipërinë

**Bruksel, 26 janar**- Në Bruksel, nesër (e martë) janarit pritet që të zhvillohet Këshilli i Ministrave të BE-së për çështjet e përgjithshme, i parë për këtë vit, në të cilin Presidenca kroate do t'i paraqesë përparësitë për gjashtë muajt e ardhshëm në krye të Unionit.
Zgjerimi dhe ambicia e kroatëve për dritën e gjelbër për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në këshillin e marsit do të jetë një prej temave që do të shpalosen nën kapitullin 'Një Evropë më e fortë në botë'. Plani i deritanishëm është arritja e një ekuilibri për t'i bindur vendet dyshuese me metodologjinë e re, duke shtuar vlerësimin e ecurisë së reformave deri sot, pas propozimeve dhe raportit të



ndërmjetëm në muajin shkurt nga Komisioni Evropian.
Po të njëjtën ditë në Bruksel do të jetë në një vizitë zyrtare edhe kryeministri shqiptar Edi Rama, i cili do të pritet në një darkë pune nga presidentja e Komisionit Ursula von der Leyen. Temat e pritshme të diskutimit do të jenë Konferenca e donatorëve e 17 shkurtit dhe ecuria e procesit të zgjerimit. Kryetarët e parlamenteve të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, do të mblidhen po në atë ditë për të diskutuar perspektivat evropiane për Ballkanin Perëndimor.
Përmes një postimi në "Twitter", presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, tha se në takim do të flitet për çështjen e zgjerimit dhe se Parlamenti Evropian mbështet në mënyrë të palëkundur perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor.

# Rama në Berlin, sot takon kancelaren Merkel

Kryeministri Edi Rama ka thënë se takimi me kancelaren gjermane Angela Merkel zhvillohet enkas për programin e rindërtimit në vigjilje të Konferencës së Donatorëve, e cila do të mbahet në Bruksel më 17 shkurt



**Tiranë, 26 janar** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është nisur të dielën për në Berlin, ku sot (e hënë) do të zhvillojë një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel.
Kryeministri Rama informoi se takimi zhvillohet enkas për programin e rindërtimit në vigjilje të Konferencës së Donatorëve, e cila do të mbahet në Bruksel më 17 shkurt. "Për në Berlin për takimin me kancelaren Merkel, enkas për programin e rindërtimit në vigjilje të Konferencës së Donatorëve, që do të mbahet në Bruksel më 17 shkurt", tha Rama.
Disa ditë më parë kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë në Itali, ku u prit nga homologu italian Giuseppe Conte dhe ministri i Jashtëm i Italisë, Luigi Di Maio, me të cilët diskutoi për organizimin e Konferencës së donatorëve më 17 shkurt në Bruksel, për rindërtimin pas tërmetit të 26 nëntorit.
Edhe zëvendës zëdhënësja e Qeverisë gjermane, Ulrike Demmer ka bërë të ditur se kancelarja gjermane Angela Merkel do të takohet sot (e hënë) në Berlin me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ajo ka thënë se në fokus të bisedës do të jetë ndihma që mund të japë Gjermania për rimëkëmbjen e dëmeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019.
Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama e kishte paralajmëruar takimin me kancelaren gjermane edhe në kuadër të vizitës së tij në Romë, ku ai mori premtimin për mbështetjen e Italisë në konferencën e donatorëve, që do të zhvillohet më 17 shkurt 2020 në Bruksel, nën udhëheqjen e kryetares së komisionit të BE-së, Ursula von der Leyen. Rama tha gjatë një bisede joformale me ministrin e Jashtëm të Italisë, Luigi di Maio, se kostoja e rimëkëmbjes së zonave të shkatërruara nga tërmeti përllogaritet deri tani të jetë afro një miliardë euro.
Temë tjetër e bisedimit, sipas Demmer, do të jetë kryesia e radhës së Shqipërisë në OSBE, marrëdhëniet bilaterale, situata në rajon dhe perspektiva evropiane e BE-së. Angela Merkel dhe Gjermania janë të angazhuar për çeljen sa më të shpejtë të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.
Pas një bisede që pati javën e kaluar me kryeministrin kroat Plenkoviq, Merkel e refuzoi trajtimin veç e veç të dy vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Nëse duam të jemi të drejtë, atëherë ne duhet t'i trajtojmë të dy vendet së bashku, pavarësisht se ato pastaj do të ndjekin procedura të ndryshme, në bazë të vlerësimeve që do t'u bëhen", tha Merkeli.

## Fushata e nisur para kohe në Maqedoni po bëhet gjithnjë e më e ashpër

**Shkup, 26 janar** - A do të ndikojë vlerësimi për zgjedhjet e ardhshme parlamentare më 12 prill, në vendimin përfundimtar për marrjen e datës, për fillimin e bisedimeve me BE-në, të cilën Maqedonia e Veriut e pret në samitin e Zagrebit në pranverë.
Bashkëbiseduesit për Alsat, thonë se partitë si aktorët kryesorë duhet të jenë të vetëdijshme për fazën në të cilën ndodhet shteti, dhe prandaj nuk duhet të lejojnë zgjedhje të parregullta, pasi ato mund të ndikojnë në vendimin e anëtarëve të BE-së. Ata theksojnë se për shkak të nivelit të ulët të kulturës politike, ata duhet të nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi, që do të çojë në sigurimin e zgjedhjeve të rregullta.
Sipas Lulzim Hazirit, në prag të marrjes së datës eventuale, partitë sikur janë "vetëdijesuar". Partitë tona fillojnë fushatat e tyre posa të kuptojnë se do të ketë zgjedhje, e jo nga data e fillimit të fushatës zgjedhore dhe tashmë gjithçka është e qartë. Sidoqoftë, ai është i bindur se asnjë parti nuk do të lejonte të luajë me shanset për në BE.
Në prag të zgjedhjeve, disa ambasadorë evropianë në vend porositën që përveç reformave dhe miratimit të Ligjit për Prokurorinë Publike, për marrjen e të datës për fillimin e negociatave me BE-në, nevojiten zgjedhje korrekte dhe demokratike.





EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kjo javë pritet të jetë kyçe për mundësinë e arritjes së koalicionit qeverisës në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

# Lutfi Haziri e përsërit: LDK-ja do balancim të pushtetit



Pavarësisht se kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, pati thënë se deri në fund të javës që lamë pas do të dalin me një konstatim se do të bëhet ose jo marrëveshja me Lëvizjen Vetëvendosje, asnjë lëvizje në këtë drejtim nuk ka pasur të dielën, përveç deklaratës së nënkryetarit të LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se një ndarje e drejtë dhe e balancuar e pushtetit mbi parimet e mirëbesimit do të bënte që programi qeverisës, me LV-në udhëheqëse të qeverisë e LDK-në udhëheqëse të Kuvendit, do t'i jepnin fuqi koalicionit

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 26 JANAR - Kanë kaluar 112 ditë prej ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, por Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk kanë arritur një marrëveshje për bashkëqeverisje. Javën e kaluar, pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së, kjo pati paralajmëruar se deri në fund të javës që lamë duhet të dihet epilogu i këtij koalicioni, por e diela nuk ka sjellë ndonjë qartësi në këtë drejtim.

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, në një deklaratë të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka thënë të dielën se një ndarje e drejtë dhe e balancuar e pushtetit mbi parimet e mirëbesimit do të bënte që programi qeverisës, me LV-në udhëheqëse të qeverisë e LDK-në udhëheqëse të Kuvendit, do t'i jepnin fuqi koalicionit. "Do t'i jepnin mirëbesim dhe shkathtësi për t'u përballur me situatën politike, pasi agjenda politike është jashtëzakonisht e rëndë karshi faktorit ndërkombëtar, karshi opozitës së organizuar, karshi qeverisë së re. E kaluara në bashkëqeverisje ka dëshmuar qartë se ne jemi gardianë të interesave të kësaj republike përmes LDK-së dhe vetëm përmes LDK-së. Partitë e tjera politike nuk i shohim si armiq, por si rivalë politikë", ka thënë Haziri.

Ai ka shtuar se do të ketë nevojë të punohet 24 orë në ditë e shtatë ditë në javë në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve, mërgimtarëve dhe ndërkombëtarëve në republikë. "Apeloj që të kemi edhe pak durim, sepse konsultimet e brendshme na mundësojnë që të eliminojmë çdolloj pengese dhe çdolloj bombe të kurdisur të mandatit katër plus (4+)", ka thënë Haziri.

Një ditë pas nominimit të Albin Kurtit nga presidenti Hashim Thaçi për kryeministër, javën e kaluar LDK-ja kishte mbajtur mbledhjen e kryesisë, ku kishte shprehur vullnetin për marrëveshje politike të balancuar me Lëvizjen Vetëvendosje, që do ta reflektonte në tërësi rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit.

Ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, pati deklaruar se brenda javës që lamë LV-ja duhet të tregojë nëse dëshiron të bëjë koalicion me të. "Ne kemi dhënë një propozim që kemi vlerësuar se është propozim i balancuar, që mendoj se LV-ja duhet ta trajtojë me vëmendje të veçantë dhe me besim të hapur të ulemi të bisedojmë, por që ajo bisedë të ketë një përfundim sa më të shpejtë, mundësisht deri në fund të kësaj jave, në mënyrë që të bëjmë marrëveshje ose të konstatojmë se nuk ka kushte që marrëveshja të bëhet. Prandaj, ne mbesim në këto pozita, por gjithsesi me vullnet që të përfundojmë një marrëveshje e cila është në dobi të qytetarëve", ka thënë Mustafa.

Mediat të premten në mbrëmje kanë raportuar për një takim larg syrit të publikut të liderit të LV-së, Albin Kurti dhe liderit të LDK-së, Isa Mustafa, në shtëpinë e këtij të fundit. Derisa këtë takim LV-ja dhe LDK-ja nuk e kanë pohuar e as mohuar, ishkëshilltari i Isa Mustafës, avokati Besnik Berisha, ka treguar se nuk ka pasur takim ndërmjet zyrtarëve të Lidhjes Demokratike dhe atyre të Vetëvendosjes në shtëpinë e Isa Mustafës. Ai ka thënë se të gjithë këto lajme për një takim të tillë në "Ranch" janë të pavërteta. "Sa lehtë i besojmë lajmet 'ekskluzive' në këtë vendin tonë, ani pse shumë nga këto janë veç hamendësime, madje nganjëherë edhe trillime. I tillë është edhe ai për takimin, në të ashtuquajturin 'Ranch', në mes të LV-së dhe LDK-së", ka shkruar Berisha në profilin e vet në "Facebook".

Edhe drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka komentuar situatën e fundit politike në vend sa i përket formimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në secilën legjislature për 20 vjet të jetës parlamentare, Kuvendi është udhëhequr nga subjekti politik i dalë i pari në zgjedhje.

Zërat brenda këtyre dy partive për arritje të koalicionit janë shtuar shumë ditët e fundit. Ishkandidati për deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, Sabri Kiçmari, ka ftuar LV-në dhe LDK-në që ta bëjnë sa më parë koalicionin qeverisës. Ai ka thënë për "Epokën e re" se këto dy subjekte politike kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike. "Unë e quaj interes nacional krijimin e një koalicioni qeverisës. Sa më parë aq më mirë. Vendi është duke u karakterizuar nga një mosstabilitet institucional prej shumë vitesh, por sidomos nga vera e vitit 2019. Mënyra se si u arnua koalicioni qeverisës mandatin e kaluar, duke u dhënë shumë fuqi pushtetore partive mezi të përfaqësuara në Kuvend, flet për foshnjërinë politike të demokracisë sonë. LV-ja dhe LDK-ja e kanë shansin të krijojnë një realitet të ri demokratik dhe t'i vendosin bazat e një kulture të re demokratike. I inkurajoj që ta bëjnë këtë gjë! Interesi partiak duhet t'i lëshojë vendin interesit kombëtar, shtetëror dhe shoqëror. Besoj ende, se në të dy subjektet ka mendje racionale, që e kanë këtë gjë parasysh dhe në ditët e ardhshme do të dëgjohet zëri i tyre", ka thënë Kiçmari.

Edhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka bërë me dije se për të arritur te marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës duhet të bëjnë kompromise. "Unë jam kundër që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Vendit tonë i duhet një qeveri e cila duhet të merret brenda mundësve me të gjitha çështjet dhe problemet që ballafaqohet Kosova. Në këtë situatë askush nuk e ka komoditetin ta çojë vendin në zgjedhje. Prandaj po them, lideri i LV-së me ekipin e vet dhe lideri i LDK-së me ekipin e vet duhet të ulen dhe ta krijojnë mirëbesimin për ta arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje. Në të kundërtën, do të ishte gabimi më i madh i tyre sipas përgjegjësisë së tyre politike që kanë pasur para elektoratit", ka thënë Rexhepi për "Epokën e re".

Lideri i LV-së, Albin Kurti, të hënën e kaluar është mandatuar nga presidenti për kryeministër. Nga ajo ditë ka nisur rrjedhja e afatit të parë ligjor prej 15 ditësh për krijimin e qeverisë së re të vendit. Nëse lideri i LV-së brenda 15 ditësh nuk mund ta formojë qeverinë e re, i mbetet në diskrecion presidentit të vendit, Hashim Thaçi, se kush do të jetë mandatari i dytë për formimin e qeverisë së re.

20 vjet me gazetën e përditshme "Epoka e re"

# DY DEKADA 'E

Gazeta "Epoka e re" ka shënuar 20-vjetorin e themelimit. Në këto dy dekada gazeta ka pasur edhe sfida, disa të rënda e disa të lehta, por deri më sot i ka kaluar të gjitha me sukses. Sot, për këtë moshë të saj, kanë uruar personalitete të jetës politike, arsimore, shkencore, kulturore dhe lexuesit e saj fanatikë. Në këtë përvjetor jubile botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka falënderuar kolegët dhe gazetarët e tanishëm si dhe qindra mijëra lexues të çmuar të gazetës dhe miqtë përkrahës të saj. Ai ka thënë se janë hapur e mbyllur rreth 15 gazeta të përditshme por, sipas tij, të ecësh fikall vetëm, për fije të perit, dhe të thuash ende botojmë një gazetë të shtypur, nuk është tregim aq i vockël në Kosovë




**PRISHTINË, 26 JANAR (ER)** - Gazeta e përditshme "Epoka e re" është themeluar më 15 dhjetor 1999, por numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000. Të shtunën "Epoka e re" ka mbushur 20 vjet që nga numri i parë. Në këto vite gazeta ka pasur edhe sfida, disa të rënda e disa të lehta, por deri më sot i ka kaluar të gjitha me sukses. Sot, për këtë moshë të saj, kanë uruar personalitete të jetës politike, arsimore, shkencore. Ata të cilët e kanë blerë dhe e blejnë për çdo ditë. Ata që kanë kujtuar vitet e tekstet e "Epokës së re" janë të shumtë. Edhe urimet për të nga ta janë të shumta e të ndryshme. Çdo mik i saj e dashamirës i shpreh jetëgjatësi dhe punë të pandalshme, sikurse deri më tash, punë të guximshme, profesionale dhe morale.

Në këtë përvjetor jubile, botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka falënderuar kolegët dhe gazetarët e tanishëm si dhe qindra mijëra lexues të çmuar të gazetës, dhe miqtë përkrahës të saj. Ai ka thënë se janë hapur e mbyllur rreth 15 gazeta të përditshme, por të ecësh fikall vetëm, për fije të perit, dhe të thuash ende botojmë një gazetë të shtypur, nuk është tregim aq i vockël në Kosovë. "20 vjet 'Epoka e re' dhe një urim për një njeri special. U rrumbullakuan 20 vjet jetë të gazetës së përditshme 'Epoka e re'. Nuk bëmë poterë as në këtë përvjetor, ndonëse jubile. Pas pak ditësh do të botohet numri 6 000 i gazetës. Janë hapur e mbyllur rreth 15 gazeta të përditshme. Të ecësh fikall vetëm, për fije të perit, dhe të thuash ende botojmë një gazetë të shtypur, kështu siç dimë e mundemi mu nëpër këtë fije peri dhe nëpër vrimë gjilpëre, nuk është tregim aq i vockël në Kosovë. Shpresojmë të shihemi në numrin 6 000 pas dy javësh me të gjithë ish-gazetarët, bashkëpunëtorët e redaktorët tanë dhe të shpërnderojmë ndonjë kujtim. Janë qindra. Sa për festa, seç u humbi lezeti diku të gjithave. Mbase, u kthehet një ditë! Unë dua t'i falënderoj të gjithë ata kolegë dhe gazetarët e tanishëm si dhe qindra mijëra lexuesit tanë të çmuar, gjithsesi juve miq, për përkrahjen e sinqertë! Me lejen tuaj, miq, dua ta falënderoj në mënyrë speciale një njeri dhe t'ia uroj këtë përvjetor. Është më besniku që e kam njohur dhe shpesh më i panjohuri për mua. Nuk di ta përshkruaj në tërësi strukturën e motivimit të tij shembullor: Shkëmbim Krasniqi, redaktor teknik, ai që e faqos gazetën çdo ditë. Po bëhen 6 000 numra dhe nuk ka munguar asnjë ditë në punë. Ndoshta është i vetmi shembull në botë. Nuk pushon kurrë, se ka frikë mos zhduket 'Epoka e re' kur të kthehet nga pushimi. Një përqafim të ngrohtë!", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" botuesi Mavraj.

## DISA NGA URIMET E LEXUESEVE ME RASTIN E 20-VJETORIT TË GAZETËS "EPOKA E RE"

**Nait Hasani,** ambasador i Kosovës në Shqipëri: Urime "Epokës së re" 20-vjetorin...

**Safete Hadergjonaj,** ish-deputete: Urime, një gazetë shembull për mediet në Kosovë dhe më gjerë. Ta pasqyrosh aktualitetin ditor, të shkruash me origjinalitet për ngjarjet, ta pasqyrosh realitetin pa anime ditore, të shkruash për të arriturat, por edhe të jesh kritik kur duhet, nuk është punë e lehtë. Këtë e ka bërë "Epoka e re" dhe ka mbetur gazeta më e besuar në Kosovë. Ju përgëzoj juve dhe mbarë stafin për punën e bërë jo pa vështirësi, por me profesionalizëm e me etikë mediale. Ju lumtë!

**Hajdar Beqa,** ish-deputet: Urime dhe suksese të reja!

**Merita Makolli,** vajza e veprimtarit Shasivar Makolli: "Epoka e re" ishte dhe mbeti shtëpia jonë, aty ku rrëfyem shpirtin dhe u ndiem të sigurt... uroj punë të mbarë dhe shumë suksese për gjithë stafin! Faleminderit Muhamet Mavraj!

**Ismail Syla, shkrimtar:** Jeni gazeta më e qëndrueshme, një arrë e fortë që nuk e theu askush deri më tani!

**Elmi Reçica, deputet:** Urime, suksese!

**Luljeta Veselaj-Gutaj, ish-deputete:** Urime! Suksese të mëtejme!

**Eqrem Zenelaj, profesor universitar:** "Epoka e re" ka bërë epokë! Urime! Suksese! Mbarësi!

**Agim Rexhepi, shoqata "Miqtë e Amerikës":** Urime! Dëshiroj që të festoni edhe shumë e shumë jubile të tjerë!

**Musa Selimi, profesor:** Urime, urime! Mendoj se "Epoka e re" është një gazetë që lidhet edhe me historinë e re të Kosovës, duke rrugëtuar së bashku! Suksese!

**Nexhmedin Spahiu, opinionist:** Muhamet Mavraj dhe "Epoka e re" janë sinonim i Kosovës së dinjitetshme, nderit dhe krenarisë për mbrojtjen dhe kultivimin e vlerave patriotike që në Kosovë kanë ekzistuar në dy dekadat e fundit, por që kanë qenë në minorancë të thellë. Së këndejmi, Muhamet Mavraj është një hero i Kosovës.

**Burim Etemaj, ish-kryeredaktor i "Epokës së re":** E guximshmja, "Epoka e re", urime ditëlindjen e 20-të! Në këtë gazetë, si shumë vajza dhe djem të ri, që u bënë emra të njohur të gazetarisë në Kosovë, kisha fatin edhe unë ta mësoj ABC-në e gazetarisë dhe të rritem profesionalisht. Në këtë 20-vjetor, si ish-kryeredaktor, uroj nga zemra që "Epoka e re" mos të ndalet kurrë në misionin e shenjtë: informimin e drejtë, të saktë, por dhe të guximshëm. Një urim i veçantë shkon për botuesin, Muhamet Mavraj, drejtorin Sadik Zeqiri, kryeredaktorin aktual, Mal Qorraj, redaktorin teknik, Shkëmbim Krasniqi, gazetarët, si dhe gjithsesi për lexuesit besnikë të "Epokës së re". Suksese të pafundme!

**Halil Selimi,** ish i burgosur politik: Gëzuar dhe me 60 000!

**Fatmir Shurdhaj, ish-kandidat për deputet:** Urime 20-vjetorin gazeta e guximshme "Epoka e re"! Urime atyre që kanë punuar dhe ende punojnë. Ju dëshiroj suksese të mëtejme.

**Lulzim Sahiti:** Urime dhe suksese të vazhdueshme për "Epokën e re" dhe gjithë stafin e saj.

**Lumnije Demi:** Urime dhe suksese në vazhdimësi, i nderuar miku ynë Muhamet Mavraj, ty

# POKA E RE’




dhe gjithë bashkëpunëtorëve të "Epokës së re".

**Tomë Gashi, avokat:** Edhe 100 të tjera. Urime!

**Faton Thaçi, zëvendësministër i MTI-së:** Urime dhe suksese të mëtutjeshme!

**Ramize Murtezi-Shala, gazetare:** Shumë urime 20-vjetori i gazetës! Ndihem shumë e lumtur që për një kohe isha pjesë e saj, madje aty mora hapat e parë të gazetarisë. Gjithkund me krenari flas për atë kohë se si me dashuri të madhe kemi punuar për të dalë në dritë diçka e mirë! Uroj shumë që kurrë të mos ketë fatin e disa gazetave të tjera! Urime!

**Shpend Fazliu, zëdhënës në QKUK:** Shumë urime juve dhe krejt stafit të gazetës! Shëndet dhe suksese edhe për shumë vjet të tjera!

**Ylber Çitaku, opinionist:** Urime përvjetori i 20-të i gazetës "Epoka e re"! Suksese të pafundme për gazetën ju z. Mavraj dhe gjithë stafit!

**Shefqete Gosalci, poete:** Gazeta "Epoka e re" ishte dhe mbeti gazetë e dritës, e diellit në qiellin e vranët të Kosovës. Që kur lindi eci vetë vertikalisht! Edhe gjatë rritjes nuk iu hetua adoleshenca, ashtu si fëmijë i burrëruar para kohe eci kryelartë nëpër relievin e ashpër.

**Ragip Gjoshi, profesor:** "Epoka e re" për këto dy dekada ishte një enciklopedi modeste e të gjitha zhvillimeve që lidhen me shtetkrijimin dhe shtetndërtimin e Kosovës. Qëndroni kështu, vertikalisht! Rritë të mëtejme kësaj të përditshmeje! Suksese të reja editorit dhe gjithë stafit!

**Mustafë B. Kadriaj, ekonomist:** Suksese të mëtutjeshme për gazetën "Epoka e re", duke uruar të ketë vetëm ditëlindje.

**Nehat Mustafa:** Urime dhe suksese "Epoka e re" dhe juve që e mbajtët gjallë për 20 vjet!

**Maxhun Osmanaj, arsimtar dhe letrar:** Urime dhe suksese 20-vjetori i shtegtimit krenar "Epoka e re". Ajo ishte dhe mbeti një zë krenar, zë i popullit me gjithë ato tundime, krajata, shpresa dhe vizione. Ajo ishte sofër e mendimit për çdo bashkëpunëtor në shumë fusha jete. Suksese në vazhdimësi!

**Baki Rexhepi, gazetar:** Urime përvjetori dhe numri i 6 000! Shumë suksese edhe më tej juve Muhamet dhe tërë ekipit tuaj!

**Flamur Hyseni, profesor:** Urime! "Epokës së re" jetë të gjatë!

**Agim Shahini, kryetar i AKB-së:** "Epoka e re" ishte dhe mbeti gazeta më e guximshme shqiptare, por edhe partnere e qëndrueshme e Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB). Urime dhe suksese të gjithë stafit të gazetës.

**Bekim Alirexhaj, ish-bashkëpunëtor i "Epokës së re":** Urime dhe suksese! Kisha kënaqësinë dhe privilegjin pak shumë të kontribuoj në gazetën "Epoka e re" në vitet e pasluftës në Kosovë. Respekt për ju dhe stafin e "Epokës".

**Besnik Kada, zyrtar i BQK-së:** Urime Muhamet Mavraj, suksese, e "Epoka" të shtegtojë e lirë në mesin e masmedias shqiptare sikurse deri tani, e drejtuar nga një kapiten i vetëm si ju! E rrallë në medien tonë.

**Ardian Jashari:** I uroj jetë të gjatë "Epokës së re" dhe juve që e mbani gjallë në këto ditë egërsie për gazetat dhe jo vetëm!

**Erald Selca, veteran i UÇK-së:** Uroj t'i mbijetoj kohës "Epoka e re"! Urime dhe sa më shumë lexues besnikë!

**Ramiz Krasniqi, avokat:** "Epoka..." ishte zëdhënëse e luftës së UÇK-së!

**Florent Muqaj, profesor:** Shumë urime... edhe më shumë suksese tutje!

**Shefqet Cakiqi-Llapashtica:** Urime! Kam bindjen se e ka arsyetuar emrin "Epoka e re" edhe si pjesë e atij ndryshimi!

**Hazir Mehmeti:** Urime "Epoka e re"! Përgëzime dhe urime botuesit dhe stafit të saj! Jemi më të fortë me ju drejt aty ku synohet: "Epoka e re"!

**Nexhat Buzuku:** Mrekulli, gazeta e shtypur është sikur ajri që e thithë në natyrë, e ke me vete kudo që shkon, kudo që ndodhesh, nuk i duhet as bateri e as valë... urime 20-vjetori i gazetës "Epoka e re"! Mos u ndaltë kurrë!

**Lirie Avdiu:** 20 vjet veprimtari janë shumë, por janë edhe vetëm fillimi i një epoke! Shumë e shumë vite të tjera janë para, prandaj pranoni urimet e mia për mbarësi dhe suksese me tutje. Gëzuar!

**Qëndresa Mustafa, ish-gazetare e "Epokës së re":** Urime Muhamet! Kënaqësi që isha pjesë e këtij mediumi. Faleminderit për shumëçka!

**Fanol Shala:** Për shënimin e 20-vjetorit të gazetës që dha shembullin e gazetarisë në vend! Mos të ndaleni sa të frymojmë. Urime!

**Afërdita Sopjani-Peci:** Suksese "Epoka e re", 20 vjet rrugëtim në kohë pa kohë! Numrat dhe vitet qofshin gjithmonë frymëzim për punën dhe përkushtimin. Suksese tutje i nderuar Muhamet Mavraj!

**Ahmet Maloku:** Muhamet Mavraj, urime për punën e madhe! "Epokës së re" edhe shumë e shumë numra.

**Afrim Mustafa, studiues:** Urime përvjetori i gazetës së vërtetë dhe thellësisht të guximshme "Epoka e re"... e përditshmja reale, shumë objektive dhe 1 milion për qind më e paanshme nga të tjerat. Urime numri i 6 000 i gazetës që nuk u ndal e s'ndalet natë e ditë për të sjellë dritë në Kosovë e shqiptari! "Epoka e re", me triumfe, drejt shekullit XXII, Shkëmbim Krasniqit edhe në numrin 60 000, është aty... "Epoka e re", heroinë e epokave tona, Muhamet Mavraj, hero i Kosovës dhe shqiptarisë...

**Aida Selimaj:** Urime dhe suksese për stafin e "Epokës"! Të gëzoni edhe ditë të tjera!

**Arbnor Sadiku, politolog:** Urime i nderuar! Është e vetmja e përditshme që shkruan lirshëm pa anime dhe nuk i përket një force të caktuar politike, por lexuesve që duan të mirinformohen e jo të keqinformohen me lajme që anojnë sa nga një parti, sa nga një tjetër! "Epoka e re", gazeta më e guximshme shqiptare! Fraza që e ka identifikuar këtë gazetë.

*Vijon në faqën 6*



# DY DEKADA 'EPOKA E RE'

*Vijon nga faqja 5*

**Xheladin Mjeku, poet:** "Epoka e re" mund të konsiderohet si njëra nga dritaret më të hapura, përmes së cilës reflektuan drita premtuese dhe shkëlqim agimesh të ndritura të një epoke të re, që po krijonim si shoqëri që përjetuam luftën, por nuk u zmbrapsëm në ndërtimin e ardhmërisë në kohën e re. Edhe atëherë kur na informonte, edhe atëherë kur nuk mungonte përkrahja e krijuesve të shumtë që po sprovoheshin me shkrimet e tyre të para, "Epoka e re" u qëndroi kujdestare e denjë në përkrahje të pandalur, për të krijuar kështu emra e vlera të reja. Uroj që numri 6 000 të bëhet shifër e shumëfishtë, duke përshkuar mesazhet e fuqishme të një shoqërie që ndërton vlera! Suksese qofshin të pandalshme edhe në të ardhmen, "Epoka e re"!

**Izet Aliu:** Urime gazetës më të guximshme shqiptare! Urime edhe njeriut më të guximshëm Muhamet Mavraj që asnjëherë nuk ka lejuar që gazeta të mos ketë guxim!

**Fatmir Beka:** Urime juve (Muhamet Mavraj) dhe të gjithë stafit! Uroj e besoj se do të mbeteni besnik ndaj informimit objektiv, të drejtë e të paanshëm! Kam respekt të veçantë për punën tuaj si para daljes së gazetës, ashtu edhe gjatë këtyre viteve! Gjithnjë vertikal e ballëhapur dhe i pajoshur nga grupet e ndryshme të cilat shumë gazeta i kanë shndërruar në paçavure! Shëndet e shumë suksese!

**Agush Buja, veprimtar:** Urime, shëndet e punë të mbarë!

**Isa Sejdiu:** Urime, urime! Gazeta "Epoka e re" mbetet një gazetë e qëndrueshme dhe e besueshme për lexuesin kosovar, që nuk vihet në shërbim të politikave ditore, por të çështjes kombëtare.

**Qerim Rexhaj:** Përgëzime i nderuar Muhamet! "Epoka e re" ishte dhe mbeti fillimi i një drite në terrin informativ të Kosovës. Ajo ishte dhe mbeti plotënia e ndërgjegjes së munguar të idealeve dhe zërit të lirisë ndër breza. Urime dhe përgëzime!

# "Epoka e re", gazeta më prestigjioze pas UÇK-së



**Nga: Ismet SYLEJMANI**

"Epoka e re" jetën e vet ka nisur me jetën e Kosovës së lirë e të çliruar nga Serbia pushtuese!

"Epoka e re", krijesa madhështore e gazetarit legjendar të popullit shqiptar, Muhamet Mavraj, nuk është vetëm gazeta më e guximshme shqiptare.

"Epoka e re" është gazeta më e lavdishme shqiptare, "Epoka e re" është gazeta më kombëtare shqiptare, "Epoka e re" është gazeta që me të drejtë mund të thuhet se është shqiptarja më shqiptare sepse, të tillë, të pashembullt e të pashoq, të madh e gjigant, të papërkulur e të panënshtruar e ka pasur dhe e ka themeluesin e saj, gazetarin më të shquar shqiptar, ish-kryeredaktorin e gazetës "Bota e re", njërin prej drejtuesve kryesorë të Unionit të Pavarur të Studentëve të Kosovës në kohën e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shqiptarin e përmasave heroike, Muhamet Mavraj!

"Epoka e re" pas përfundimit të luftës së UÇK-së është gazeta e cila mund të krahasohet me gazetat më të mëdha e më të fuqishme të botës.

"Epoka e re" me plot të drejtë mund të thuhet se ishte sikur gazeta "Zëri i Popullit" pas LANÇ-së në Shqipëri, sikur "The New York Times" në Amerikë, sikur "The Guardian" në Angli, sikur "Allgemaine Zeitung" në Gjermani e si shumë të tjera të mëdha, prej të cilave mëson ngjarje të mëdha, informohesh për herë të parë e shumë të tjera informacione që vetëm kjo gazetë guxon dhe ka të drejtë e para t'i bëjë publike.

Themeluesi i gazetës "Epoka e re", gazetari legjendar Muhamet Mavraj, është i vetmi gazetar shqiptar që para dhe gjatë luftës së UÇK-së, kur ishte kryeredaktor i gazetës studentore "Bota e re", brenda faqeve të saj botonte artikuj të tërë e informacione të gjithanshme nga gazeta "Zëri i Kosovës", organ i LPK-së.

"Epoka e re" u bë gazeta e parë dhe e fundit që brenda vetes ka dy gazeta të mëdha të së kaluarës: "Zërin e Kosovës" dhe "Botën e re".

Në faqet e gazetës më të guximshme shqiptare "Epoka e re" iu bë jehonë më e madhe luftës së armatosur çlirimtare të UÇPMB-së e të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Duke qenë se ishte pasardhësja e atyre dy gazetave të mëdha të cilat përfaqësonin historitë e tyre të ndryshme të së kaluarës, themeluesi historik i "Epokës së re", i papërsëritshmi Muhamet Mavraj, ndërtoi te "Epoka e re" atë gazetë madhështore, trime e heroike, që u bë pasqyruesja e realitetit të ri në Kosovën e lirë dhe zëdhënësja besnike e jetës së popullit shqiptar të Kosovës.

Suksese edhe më të mëdha gazetës së famshme "Epoka e re"!

Shëndet e suksese themeluesit të saj, shokut dhe mikut tim të madh Muhamet Mavraj!

Shëndet e suksese stafit të mrekullueshëm të "Epokës së re"!

**Prishtinë, 26 janar 2020**




**Qemajl Rexhepi:** Urime ky jubile i "Epokës së re", juve z. M. Mavraj dhe gjithë stafit përcjellës! Një gazetë e cila në çdo çast ishte në mbrojtje të vlerave më sublime të popullit, UÇK-së!



**Jeton Mazrekaj, gazetar:** Urime viti jubilar edhe shumë vite të tjera! Ishte kënaqësi që isha korrespodent nga komuna e Deçanit nga 2004 deri në 2007. Suksese të mëtejme!

**Ilir Ismajlaj:** Urime, urime e suksese! Gjithë këtë kohë e kam lexuar vetëm këtë gazetë. "Epoka e re", respekt për ju i nderuar (Muhamet Mavraj), se ke qenë real në shkrime e në lajme.

**Skënder Shabani, QKUK:** Urime, ju priftë e mbara në të ardhmen! Suksese!

**Xhevdet Smakiqi:** Urime 20 vjet "Epoka e re", gazeta më e guximshme shqiptare!

**Meti Belaj:** Urime 20-vjetorin e gazetës "Epoka e re", ty i nderuar Muhamet Mavraj, lexuesit, dhe gjithë stafit të gazetës! Urime për punën e palodhshme dhe kontributin tuaj të madh në ngritjen e nivelit të vetëdijes individuale dhe kolektive të shoqërisë shqiptare! Tranzicioni i çdo shoqërie mbetet barra më e rëndë e një redaksie mediale të profesionalizuar. Suksese në çdo hap të përballjes me realitetin e sotëm dhe atë të nesërm të shoqërisë tonë përparimtare! Respekt!

**Hakif Mehmeti:** Shumë urime i nderuar z. Muhamet Mavraj për përvjetorin e 20 të gazetës "Epoka e re", gazetë në të cilën gjithmonë ne lexuesit e rregullt gjetëm vetëm të vërtetën rreth zhvillimeve në vend dhe jashtë. Sidomos merita të veçanta, z. Mavraj, keni për mbrojtjen e vlerave të luftës së drejtë të UÇK-së. Respekt juve dhe gjithë stafit të gazetës!

# Gazetë me përgjegjësi profesionale dhe shtetndërtuese



Nga: Ismet RASHITI, publicist

Gazeta e përditshme "Epoka e re" përgjatë dy dekadave ka qenë një dritare e veçantë e informimit dhe trajtimit të temave me interes shtetndërtues dhe kombëtar. Pavarësisht prej vështirësive të natyrave të ndryshme, "Epoka e re" ka arritur ta krijojë identitetin e vet të veçantë në botën shqiptare. Puna e madhe dhe përkushtimi i redaktorëve, gazetarëve dhe gjithë stafit tjetër kanë bërë që kjo gazetë jo vetëm të mbijetojë në tregun informativ, por edhe të sigurojë lexueshmëri të të gjitha profileve shoqërore.
Kontribut të veçantë ka dhënë sidomos themeluesi i saj, publicisti dhe gazetari Muhamet Mavraj, i cili edhe në rrethana pothuaj krejtësisht të pamundura i dha frymë gazetës "Epokës e re". Dy dekada nuk janë pak, janë tepër shumë, sidomos në rrethanat e vështira të pasluftës, kur është kërkuar një informim i shpejtë dhe korrekt. Është ndër gazetat e vetme që i lëshoi hapësirë mërgatës shqiptare, kudo në botë, duke pasqyruar figura të mëdha kombëtare, ngjarje dhe informata të shumta. Gazeta "Epoka e re" është gazetë me përgjegjësi të lartë profesionale dhe shtetndërtuese ndaj lexuesit shqiptar kudo që ndodhet, i cili ka nevojë të madhe për një informim të tillë korrekt, kombëtar dhe profesional siç është "Epoka e re"!
Me "Epokën e re" erdhi një epokë e re në terrin informativ që mbretëronte gjatë viteve më të rënda. Urime dhe punë të mbarë për suksese të reja në të ardhmen!

# Rritet numri i rezonancave magnetike dhe i shërbimeve radiologjike

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 JANAR - Në Klinikën e Radiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është rritur numri i kontrollimeve me Rezonancë Magnetike, Tomografive të Kompjuterizuara (TK-CT), angio TK-CT-ve, biopsive dhe shërbimeve të tjera radiologjike.
Angazhimi i menaxhmentit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe i Klinikës së Radiologjisë, për t'u pajisur me pajisje të reja dhe riorganizimi i punës, kanë ndikuar në rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara.
Sipas raportit të kësaj klinike, me angazhimin e personelit të klinikës gjatë vitit 2019 janë kryer 9 133 kontrollime me rezonancë magnetike, përderisa në vitin 2018 ishin kryer 5 826 kontrollime.
Në bazë të të njëjtave statistika, numri i Tomografive të Kompjuterizuara (CT) ka shënuar rritje: më 2019 janë realizuar 21 501, kundrejt 19 922 që ishin kryer më 2018.
Në vitin 2019 janë kryer 1 086 TK angiografi, kurse në vitin 2018 janë realizuar 386 TK angiografi.
Stafi i kësaj klinike ka rritje 95 për qind për numrin e biopsive të kryera, duke realizuar 707 sosh, kurse një vit më parë ishin kryer 362 biopsi.
Rritje ka pasur edhe për sa i përket numrit të radiogrameve (röntgene) e që janë realizuar 77 338, krahasuar me vitin paraprak kur ishin kryer 76 668 radiograme.
Gjatë këtij viti, pas pajisjes me aparatin e dytë të rezonancës magnetike dhe një aparati të Tomografisë së Kompjuterizuar (TK-CT), pritet që edhe më tutje të rritet numri i shërbimeve dhe të rritet kualiteti i tyre, meqë klinika është furnizuar me tre injektorë automatikë.
Klinika e Radiologjisë është në renovim e sipër dhe pritet që së shpejti të përurohen hapësirat e reja, duke ofruar kushte optimale për personelin dhe pacientët me pritoren e re.



# Pastrohet ambienti përreth liqenit të Badocit



Prishtinë, 26 janar (ER) - Një numër qytetarësh i janë bashkuar grupit për mbrojtjen e liqenit të Badocit, ku në mënyrë vullnetare kanë zhvilluar të dielën një aksion për pastrimin e liqenit. Përveç pastrimit, qëllimi i këtij aksioni ishte edhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për ruajtjen e ambientit dhe moshedhjen e mbeturinave rreth liqenit të Badocit, liqen ky i cili furnizon banorët e Prishtinës me ujë të pijshëm.
Nga grupi i vullnetarëve, Milot Kurshumlia ka theksuar se aksioni për pastrimin e liqenit të Badocit është organizuar nga vullnetarë të cilët janë duke e shfrytëzuar rënien e nivelit të ujit në mënyrë që ta pastrojnë në thellësi liqenin. Kurshumlia ka thënë se pastrimi i liqenit nuk është organizuar si shenjë pakënaqësie rreth ndërtimeve që priten të fillojnë afër liqenit të Badocit, por për një ambient të pastër.
Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) "Prishtina", Ilir Avdullahu, ka thënë se kjo kompani ka përkrahur këtë iniciativë të qytetarëve dhe i është bashkangjitur asaj. Sipas tij, në të ardhmen disa segmente të Badocit duhet të rrethohen në mënyrë që liqeni të mos ketë telashe çdo vit me mbeturinat.

## Komuna e Junikut dhe Deçanit organizojnë olimpiadën në matematikë

JUNIK, 26 JANAR (ER) - Komuna e Junikut ka bërë me dije se në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut" është mbajtur olimpiada në matematikë. Kjo komunë u ka uruar suksese të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve pjesëmarrës në këtë garë. Koordinatore për Komunën e Junikut në olimpiadën matematike është caktuar Ajete Gjuli. Edhe në komunën e Deçanit është mbajtur kjo garë, ku 63 nxënës i janë nënshtruar testit në matematikë. "63 nxënës të shkollave të komunës së Deçanit i janë nënshtruar testit në garën komunale Olimpiada e Matematikës, organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Deçan. Gara u mbajt në ambientet e Shkollës së Mesme Teknike Profesionale 'Tafil Kasumaj' në Deçan", ka njoftuar komuna e Deçanit. Sipas këtij njoftimi, drejtori i DKA-së, Bekim Vishaj, ka falënderuar drejtorin e shkollës "Tafil Kasumaj", Zenel Kasumaj, për angazhimin e tij dhe gatishmërinë e vazhdueshme të bashkëpunimit, sidomos për arsimin deçanas. Gjithashtu, Vishaj ka përgëzuar profesorin Muharrem Kukalaj për profesionalizmin e treguar gjatë gjithë kohës si dhe ka falënderuar të gjithë mësimdhënësit për punën e tyre në të mirë të nxënësve.



# Transporti i 'izoluar' hekurudhor i Kosovës



PRISHTINË, 26 JANAR - Ambasadori amerikan në Berlin, Richard Grenell, i cili shërben si i Dërguar Special Presidencial për Negociatat Paqësore të Serbisë dhe Kosovës, ka thënë se Kosova dhe Serbia do të arrijnë shumë shpejt një marrëveshje për transportin hekurudhor. Sipas tij, kjo do të jetë marrëveshja e dytë ekonomike mes të dyja vendeve pas marrëveshjes për transportin ajror që u arrit më 29 janar në Berlin, në bazë të së cilës pritet që të lëshohet në qarkullim një linjë ajrore direkte mes Prishtinës dhe Beogradit.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se e përshëndet synimin për t'i rivendosur lidhjet hekurudhore midis Kosovës dhe Serbisë gjë që, sipas tij, shënon "një tjetër hap të rëndësishëm drejt normalizimit të plotë" të marrëdhënieve midis dy vendeve. Thaçi i bëri këto komente në "Twitter", në ditën kur presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, paralajmëroi arritjen e një marrëveshjeje për linjën hekurudhore midis Beogradit dhe Prishtinës.

## Cila është gjendja e transportit hekurudhor në Kosovë?

Transporti hekurudhor në Kosovë është një nga sistemet më të dobëta në rajon. Aktualisht në qarkullim janë vetëm dy linja nëpër të cilat kalojnë trenat e Kosovës. Linja Prishtinë - Hani i Elezit, që operon një herë në ditë dhe një biletë kushton 2.5 euro, si dhe linja që qarkullon dy herë në ditë në relacionin Prishtinë - Pejë, për të cilën një biletë njëdrejtimëshe kushton 3 euro. Të dy linjat bëjnë vetëm transportin e udhëtarëve. Numri i udhëtarëve ka shënuar rënie në dhjetëvjetëshin e fundit. Në vitin 2007 me tren kanë udhëtuar 417 000 udhëtarë, kurse në vitin 2018 trenin e kanë përdorur 120 000 udhëtarë. Trenat e Kosovës sot nuk lidhen me asnjë linjë ndërkombëtare, ndërkohë që gjatë kohës së ish-Jugosllavisë qytetarët e Kosovës e kanë pasur mundësinë që të udhëtojnë duke shfrytëzuar hekurudhat e Kosovës për në shumë vende perëndimore, pasi trenat e Kosovës kanë qenë të lidhur me linjat ndërkombëtare.

## Trenat dhe Serbia

Linja që dikur lidhte Kosovën me Serbinë aktualisht nuk është funksionale për shkak të tensioneve të vazhdueshme politike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Që nga viti 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, linja që lidhte Kosovën me Serbinë përmes Mitrovicës nuk është funksionale. Por, kjo nuk e ka penguar Serbinë që të ofrojë shërbime hekurudhore brenda territorit të Kosovës.

Trenat e hekurudhës së Serbisë operojnë brenda territorit të Kosovës, pavarësisht se konsiderohen ilegalë nga autoritetet në Prishtinë. Dy herë në ditë trenat e "Srbija Voz" operojnë nga qyteti i Kraljevës në Serbi për në Mitrovicë të Veriut. Operimi i trenave të hekurudhës së Serbisë brenda territorit të Kosovës vazhdon pavarësisht një vendimi të vitit 2017 të lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës, që i shpallë ilegalë trenat serbë që operojnë në territorin e Mitrovicës Veriore.

## Sherri me "trenin serb"

Në fillim të vitit 2017 Serbia tentoi ta dërgonte një tren në Kosovë, në të cilin ishte ngjyrosur flamuri serb dhe shkruante në shumë gjuhë botërore "Kosova është Serbi". Tentimi i autoriteteve serbe për ta futur këtë tren në territorin e Kosovës pati tensionuar edhe më tepër situatën mes Prishtinës dhe Beogradit. Institucionet e Kosovës dërguan në Mitrovicë Veriore forca të shumta policore me qëllim që me çdo kusht ta parandalonin futjen e trenit. Treni u ndal nga Policia e Kosovës dhe u kthye nga ishte nisur.

## Modernizimi i transportit hekurudhor

Hekurudhat e Kosovës nuk janë mirëmbajtur si duhet që nga fillimi i viteve '90, kur kanë filluar luftërat në ish-Jugosllavi. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës kanë filluar edhe planet për të bërë investime në modernizimin e transportit hekurudhor. Investimet parashihet që të bëhen në atë që njihet si "Korridori i 10-të", përkatësisht hekurudha që shkon nga kufiri me Maqedoninë e Veriut, përshkon Kosovën dhe kalon në Serbi për ta lidhur Kosovën me vendet e Evropës Perëndimore. Linja do të jetë e gjatë 148 kilometra. Sipas ekspertëve, kjo linjë parashihet të ketë ndikim të madh në ekonominë e Kosovës për shkak të transportit të udhëtarëve dhe mallrave. I gjithë projekti do të kushtojë rreth 200 milionë euro dhe pritet të përfundojë në vitin 2024. Paratë për modernizmin e "Korridorit të 10" parashihet të jenë kredi që Kosova do t'i marrë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si dhe donacione nga Bashkimi Evropian.

## Transporti i mallrave

Trenat e Kosovës në të kaluarën kanë qenë ndër transportuesit më të mëdhenj të mallrave. Transportimi i mallrave për në Kosovë është bërë përmes linjës që ka lidhur Kosovën me Maqedoninë e Veriut, si dhe asaj që ka lidhur Kosovën me Serbinë. Mirëpo, në 30 vjetët e fundit transporti i mallrave ka shënuar rënie për shkak edhe të mosfunksionimit të rregullt të linjave hekurudhore dhe problemeve politike që kanë afektuar qarkullimin normal të trenave. Aktualisht, kompania "Ferronikeli" që gjendet në komunën e Gllogovcit, e cila bën prodhimin e nikelit, është kompania që përdorë më së shumti hekurudhat e Kosovës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2018 hekurudhat e Kosovës kanë transportuar 479 mijë tonë mallra.

## Gjendja e trenave dhe hekurudhave

Lokomotivat dhe vagonët janë pa mirëmbajtje të duhur dhe shumë të vjetruar. Hekurudhat, po ashtu, janë në gjendje të keqe. Në shumë vende të Kosovës nuk ka fare laura në pikat ku kryqëzohen hekurudhat me rrugët që përdoren për qarkullim rrugor. Kjo ka bërë që shumë shpesh të ndodhin aksidente me fatalitet.

## Historiku i hekurudhës së Kosovës

Ndërtimi i hekurudhës së Kosovës filloi në vitin 1874. Vija e parë hekurudhore ishte në relacionin Hani i Elezit - Fushë Kosovë - Mitrovicë. Në vitin 1931 vazhdoi ndërtimi i kësaj linje në relacionin Mitrovicë - Leshak, më 1934 Fushë Kosovë - Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë - Pejë, më 1949 Prishtinë - Podujevë - Livadhi dhe më 1963 Klinë - Prizren. Hekurudha e Kosovës ka një gjatësi prej rreth 333 kilometrash. (REL)



# 420 milionë euro të hyra nga akciza

Mallrat e akcizës apo mallrat e luksit siç njihen ndryshe në vitin që lamë pas, arkës së shtetit ia kanë siguruar 420 milionë euro. Fadil Berjani, kryetar i Shoqatës së Naftëtarëve, ka thënë se naftëtarët mbushin rreth 30 për qind të buxhetit dhe, sipas tij, akciza që duhet ta paguajnë është më e larta se e shteteve në rajon. Njohësi i çështjeve ekonomike, Zekirja Shabani, ka theksuar se rritja e të hyrave nga Dogana është lajm i keq për ekonominë e vendit sado që mbushet arka e shtetit. Sipas tij, me rritjen e të hyrave nga kufiri do të duhej të alarmoheshin institucionet për shkallën e ulët të prodhimit vendor dhe deficitin e madh tregtar



Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 JANAR - Mallrat e akcizës apo mallrat e luksit siç njihen ndryshe në vitin që lamë pas arkës së shtetit ia kanë siguruar 420 milionë euro që, krahasuar me periudhën paraprake, kjo shumë ka shënuar rritje për 27 milionë euro.
Lidhur me këtë, zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në buxhetin e shtetit vetëm nga produktet me akcizë janë shtuar 420 milionë euro. "Në vitin që lamë pas produktet me akcizë gjatë këtij viti kanë paguar vlerë të lartë të taksave. Dogana ka mbledhur rreth 420 milionë euro derisa vitin e kaluar kishim 393 milionë euro taksa të mbledhura. Pra, taksa e akcizës sjell mesatarisht brenda një viti rreth 400 milionë euro", ka thënë Stavileci, duke shtuar se në këto produkte prijnë produktet e naftës dhe duhani, ndërkaq importi është kryesisht nga vendet e Unionit Evropian.
Fadil Berjani, kryetar i Shoqatës së Naftëtarëve, ka thënë se naftëtarët mbushin rreth 30 për qind të buxhetit dhe, sipas tij, akciza që duhet ta paguajnë është më e larta se e shteteve në rajon. "Sa i përket sektorit të naftës më këtë ne e mbushim buxhetin e shtetit përafërsisht 30 për qind. Sektori i naftës kërkon një perceptim më të mirë pasi është kontribuuesi më i madh në buxhetin e shtetit. Shtetet në regjion e kanë akcizën e naftës më të ulët. Maqedonia e ka akcizën për 22 centë më të ulët", ka thënë Berjani, duke shtuar se sa i përket çmimit të derivateve, Kosova i ka çmimet më të lira në rajon. "Akciza e gazit duhet të hiqet, kjo është kërkesë e Shoqatës së Naftëtarëve", ka thënë ai.
Edhe njohësi i çështjeve ekonomike, Zekirja Shabani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rritja e të hyrave nga Dogana është lajm i keq për ekonominë e vendit sado që mbushet arka e shtetit. Sipas tij, me rritjen e të hyrave nga kufiri do të duhej të alarmoheshin institucionet për shkallën e ulët të prodhimit vendor dhe deficitin e madh tregtar. "Kosova vazhdon të ketë varshmëri gati të plotë buxhetore nga taksat dhe tarifat doganore. Kjo edhe është arsyeja që të gjitha qeveritë projeksionet financiare i bëjnë duke u bazuar fillimisht në të hyrat nga Dogana e pastaj nga ato të Administratës Doganore. Megjithatë, rritja e të hyrave nga Dogana është lajm i keq për ekonominë e vendit sado që mbushë arkën e shtetit. Me rritjen e të hyrave nga kufiri do të duhej të alarmoheshin institucionet për shkallën e ulët të prodhimit vendës dhe deficitin e madh tregtar", ka thënë Shabani, duke shtuar se kjo pastaj dikton edhe inflacionin në vend dhe gjendjen socio-ekonomike. "Për këtë arsye qeveria e ardhshme do të duhej të fokusohej në politikat fiskale dhe t'i rishikonte taksat e akcizës, sidomos për naftën dhe mallrat që aktualisht futen në kategorinë e atyre luksoze", ka deklaruar Shabani.

## Përjashtimet nga akciza

Akciza nuk paguhet për: (a) Lëndën e parë dhe lëndën ndihmëse e cila përndryshe do t'i nënshtrohej akcizës, të importuar në Kosovë nga personat e pajisur me licencë të lëshuar nga Dogana e Kosovës, i cili autorizon importin e tillë në rastin kur lënda e tillë do të përdoret në prodhimin e mallrave për eksport; (b) Mallrat për të cilat drejtori i përgjithshëm i Doganës Kosovës përcakton se do të shfrytëzohen vetëm për qëllime humanitare dhe se nuk do të ofrohen për shitje a për konsumim në Kosovë; dhe (c) Mallrat e financuara nga të hyrat e granteve të dhëna për Qeverinë e Republikës Kosovës nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare apo joqeveritare në përkrahje të programeve humanitare dhe të rindërtimit si dhe të projekteve në Kosovë.
Organizatat dhe subjektet e tjera që nuk paguajnë akcizë: (a) Misionet e huaja diplomatike dhe konsulare; (b) Kombet e Bashkuara apo cilido organ i saj, duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe agjencitë qeveritare përkitazi me mallrat e përdorura për qëllime zyrtare; (c) Kontraktorët e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe të KFOR-it të cilët importojnë mallra që do të përdoren nga ata kontraktorë vetëm përkitazi me përmbushjen e kontratave për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe për KFOR-in dhe (d) Organizatat e regjistruara joqeveritare me status të beneficuar publik siç parashihet me Rregulloren nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 për mallrat e përdorura vetëm nga organizatat joqeveritare në përmbushjen e qëllimeve të statusit të saj të beneficuar. Këto mallra janë si në vijim: benzina, kerozina, nafta dhe etanoli.

# Digjet një objekt që menaxhohej nga AKP-ja në Suharekë

**Suharekë, 26 janar - Persona të panjohur ia kanë vënë zjarrin objektit të një ish-ndërmarrje e cila menaxhohej nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Rasti ka ndodhur në fshatin Studenqan të Suharekës. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë policore dhe zjarrfikësit, të cilët kanë arritur ta shuajnë zjarrin.**



# Roli i Britanisë së Madhe në Luftën e Dytë Botërore

Në Luftën e Dytë Botërore Britania e Madhe ishte i vetmi vend evropian që ishte në luftë me Gjermaninë naziste dhe mbeti e papushtuar nga ajo. Të gjitha shtetet e tjera ose ishin pushtuar, ose ishin rreshtuar me forcat e boshtit duke u bërë satelit të tyre!

Prof. msc. Shemsi OSMANI

### Përpjekja e Britanisë së Madhe që ta parandalonte Luftën e Dytë Botërore!

Para se të shpërthente Lufta e Dytë Botërore, Britania e Madhe kishte provuar diplomacinë preventive, duke u munduar ta ndalonte Hitlerin në planet e tij. Prandaj kishte dërguar në Berlin kryeministrin Richard Chamberlain! (1937 - 1940) i cili është i njohur për politikën e tij të jashtme të pajtimit, duke bërë përpjekje për ta zgjidhur krizën ai vizitoi Hitlerin në malin e tij privat në Berchtesgaden, aty ku ai hartonte në qetësi planet e tij pushtuese.

Në vazhdën e përpjekjeve për ta ndalur Hilerin këshillohej edhe shtypi britanik, që në opinionin publik ta paraqiste Hitlerin si një lider të paqes. Duke provuar që edhe në këtë mënyrë të ndikohej në personalitetin e tij për ta ndërruar kahun e planeve të tij. Kështu këshillonte ambasadori britanik në Gjermani, Nevile Henderson, i cili, po ashtu, shfrytëzoi çdo mundësi të kontakteve të tij me Hitlerin që ta bindë atë të zgjidhte rrugën e paqes, ambasadori Henderson nuk u ndal nga përpjekja e tij, deri në ditën e fundit kur Gjermania nuk pranoi ultimatumin e qeverisë britanike për tërheqje nga Polonia.

Diplomacia britanike, duke u munduar ta ruante paqen, shkoi deri aty sa kryeministri britanik Sir Neville Chamberlain, në kthimin e tij nga bisedimet me Hitlerin, në Aeroportin Heston të Londrës, më 24 shtator 1938 deklaron se: (Kam sjell me vete kushtet e një plani), që më vonë do të quhet "Marrëveshja e Munihut", ndërsa Britania e Madhe do të "pajtohej" që Gjermania t'i aneksonte Krahinat Sudete të Çekosllovakisë (tani Republika e Çekisë dhe Republika e Sllovakisë). Kjo ishte edhe një përpjekje për qetësimin e Hitlerit. Por Hitleri nuk u ndal me kaq, planet e tij ishin shumë më të mëdha dhe më të frikshme.

### Fillimi i Luftës së Dytë Botërore dhe Britania e Madhe

Pas gjithë këtyre përpjekjeve britanike për paqe, Hitleri përsëri hodhi hapin e pushtimit dhe më 1 shtator 1939 sulmoj Poloninë. Por këtë akt Britania nuk mundi ta kapërdinte dhe më 3 shtator 1939, së bashku me Francën, i shpallën luftë Gjermanisë Naziste. Pasi Britania i shpalli luftë Gjermanisë kryeministri Chamberlain iu drejtua qytetarëve britanikë nëpërmjet BBC-së, duke thënë se ishte i trishtuar sepse "lufta e gjatë për të fituar paqen kishte dështuar". Ai vazhdoi: "Nuk besoj se mund të kisha bërë diçka tjetër që do të ishte më e suksesshme", burimi BBC.

### Në këto rrethana u formua një kabinet i luftës

Kabineti i Luftës përbëhej nga nëntë anëtarë dhe në këtë përbërje ishin edhe dy ministra të rinj, duke përfshirë Winston Churchill si ztr. i parë i Admiralitetit, post që ai mbajti edhe në periudhën e Luftës së Parë Botërore. Ztr. Hankey bëhet ministër pa portofol, ndërsa ztr. Anthony Eden do të emërohej sekretar i Dominionit, me qasje të veçantë në Kabinetin e Luftës i cili kishte dhënë dorëheqje nga posti i Sekretarit të Punëve të Jashtme një vit më parë, sepse nuk ishte dakord me politikën e pajtimit të kryeministrit Neville Chamberlain me Gjermaninë hitleriane.

Po ashtu, siç ishte e vendosur për ta ruajtur paqen, Britania e Madhe tregoi vendosmërinë e saj të palëkundur edhe në luftë kundër nazifashizmit. Duke luftuar me Japoninë dhe në të njëjtën kohë mbron: Anglinë, Evropën, Egjiptin dhe Lindjen e Mesme, nga Gjermania e Hitlerit i cili ishte i vendosur të pushtonte të gjithë Evropën kontinentale nga Atlantiku deri në Moskë.

Por kjo e kishte koston e vet, në pesë vjetët e ardhshëm britanikët duhej t'i duronin bombardimet e qyteteve të tyre nga operacionet e forcave ajrore gjermane të ashtuquajtura "Blitz", që hidhnin bomba dhe raketa mbi civilë. Nga këto bombardime u vranë 60 595 civilë dhe 86 182 u plagosën rëndë.

Në këto rrethana u bë një mobilizimi i shkëlqyer i tërë shoqërisë britanike për rezistencë, por ishte edhe një barrierë natyrore që vështirësonte sulmin tokësor, Kanali Anglez i cili ndan ishullin e Britanisë së Madhe, nga pjesa tjetër e Evropës, kjo specifikë gjeografike ndikoi në formësimin e karakterit të veçantë të popullit britanik.

Vendosmëria britanike u tregua në të gjitha frontet, por vetëmohimi i ushtarakëve britanikë u shqua veçanërisht në dy beteja, që ishin vendimtare: Fitorja e Field Marshal Montgomery në Afrikë, i njohur për vendimet e tij decizive i cili më 23.10.1942 drejtoi operacionin e quajtur "Lightfoot" kundër El Alamein në Egjipt dhe pas 12 ditësh e mori atë, duke zënë 30 mijë rob lufte të Forcave të Boshtit! Kjo ishte goditja e parë e rëndësishme e forcave britanike. Por edhe më i rëndësishëm ishte zbarkimi angloamerikan në Normandi. Më 6 qershor 1944, më shumë se 156 000 trupa amerikane, britanike dhe kanadeze sulmuan 50 milje të plazheve të Normandisë në Francën veriore, të mbrojtura fuqishëm nga forcat gjermane. Ky operacion i cili ishte pikë kthese kritike në Luftën e Dytë Botërore. Nga aty filloi çlirimi i Evropës nga pushtuesit nazistë dhe Gjermania u dorëzua dhe nënshkroi kapitullimin pa kushte më 7 maj 1945, ndërsa Japonia kapitulloj më 2 shtator 1945.

### Britania e Madhe në konferencat ndërkombëtare gjatë dhe në fund të LDB-së

Presidenti i ShBA-së, Franklin D. Roosevelt dhe kryeministri britanik Winston Churchill, u takuan më 14 gusht 1941 në Newfoundland (Argjentinë) pas takimit të dy krerëve të shteteve bënë një deklaratë të përbashkët, e njohur si "Karta e Atlantikut", duke i bërë të qartë opinionit botëror qëllimet e luftës së ShBA-së dhe Britanisë. Karta e Atlantikut garantonte lirinë e popujve, vetëvendosjen dhe zgjedhjen e formës së qeverisjes nga vetë popujt. Po ashtu, në Konferencën e Tehranit (Iran) më 28 nëntor dhe më 1 dhjetor 1943, britanikët propozojnë që një front i dytë të hapej në Ballkan e jo në Evropën Perëndimore! A nuk ishte qëllimi i tyre për ta shpëtuar Ballkanin dhe Evropën Lindore nga pushtimi i ushtrisë së kuqe sovjetike?

Konferenca e Moskës, 9 tetor 1944 dhe përpjekja britanike për t'i shpëtuar vendet e Evropës Lindore nga instalimi komunist sovjetik e deri te marrëveshja me përqindje territoriale të ndikimit sovjetik apo perëndimor. Ndërsa në konferencën e Jaltës nga 4 deri më 11 shkurt 1945, kryeministri britanik Winston Churchill dhe presidenti Roosvelt në takim me Stalinin u munduan që ta siguronin premtimin e Stalinit, për vendosjen e sistemit demokratik dhe zgjedhjet e lira. Stalini kishte premtuar se zgjedhje të "lira" do të ketë, por ai kishte menduar të "lira" sipas mënyrës së tij. Ndërsa përpjekje e veçantë është bërë për ta shpëtuar Poloninë dhe u deklarua se: Do të formohej një Qeveri e Unitetit Kombëtar e përbërë nga komunist dhe jokomunist dhe vetëm pastaj u publikua deklarata e Çlirimit të Evropës. Ndërsa në Konferencën e Potsdamit (Gjermani), 17 korrik 2 gusht 1945, aleatët angloamerikanë ishin të alarmuar sepse në Evropën Lindore tashmë komunistët kishin ardhur në pushtet. Nga përpjekja britanike për paqe me Hitlerin e deri te lufta kundër tij dhe fitorja mbi forcat e boshtit mund të konkludojmë se: Britania e Madhe kishte mbajtur qëndrim të drejtë, e cila kundërshtoi pushtimet dhe të gjitha të këqijat që i solli nazifashizmit, duke paguar një çmim shumë të lartë por, njëkohësisht, kishte fituar admirimin e opinionit botëror për rezistencën e bërë dhe gjatë LDB-së ishte shpresë për aleatët se një ditë do t'i vijë fundi edhe makinerisë ushtarake dikur shumë të fuqishme hitleriane. Por edhe në konferencat ndërkombëtare diplomacia britanike si gjatë luftës edhe në përfundim të saj me zgjuarsi provonte ta parandalonte një tjetër të keqe edhe më të madhe! Komunizmin sovjetik që amerikanët vetëm më vonë e kuptuan, vetëm pasi sovjetikët dhe ushtria e tyre e kuqe pushtuan Evropën Lindore!



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (10)

# Magnetizimi i pllakave feromagnetike mbi polet e magnetit (?) dhe (?)



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Magnetizimi i pllakave të hekurit mbi polet e magnetit kërkon një qasje tjetër të kuptuarit. Së pari duhet kuptuar se si ndodh magnetizimi i pllakave të hekurit mbi polet magnetike. Por për t'i sqaruar edhe më thjesht duhet t'i kthehemi edhe një herë eksperimentit dy, me ç'rast theksuam se kur të vendosen pllakat e hekurit (a) dhe (b) mbi polet magnetike (?1) dhe (?2) kemi një rritje të fluksit të fushës magnetike (??) dhe (??). Shiko figurën 15.

Pasi mikrogrimaca (?), (?) dhe (?) kanë nivel energjetik shumë më të vogël se grimcat elementare vetërigjeneratore pasi të burojnë nga këto grimca orientohen për të dalë nga polet magnetike (?1) dhe (?2) të magnetit, kurse pasi të dalin nga këto pole formojnë flukset e fushave magnetike simetrike (??) dhe (??).

Pllakat e hekurit (a) dhe (b) kanë një nivel shumë të ulët energjetik, por në momentin kur vendosen mbi polet magnetike veprojnë njëkohësisht forcat tërheqëse dhe shtytëse në mes protoneve, elektroneve dhe neutroneve të magnetit simetrik dhe pllakave të hekurit në të dy polet magnetike (?1) dhe (?2). Dipolet magnetike (?), (?) dhe mikrogrimca (?) kanë nivel energjetik ekstrem të lartë në krahasim me nivelin energjetik të protoneve elektroneve dhe neutroneve te pllakat e hekurit (Fe), Dhe në momentin e parë të kontaktit kemi një ç'rregullim total të niveleve energjetike të protoneve elektroneve dhe neutroneve në të dy polet magnetike. Në këtë mënyrë një pjesë e nivelit energjetik kalon te protonet elektronet dhe neutronet e pllakave të hekurit(Fe), kështu që këto mikrogrimca nga pllakat e hekurit pasi ta pranojnë këtë energji kalojnë në mikrogrimca (?''), (?'') dhe (?'') por që kanë një nivel energjetik më të ulët se vetë grimcat(?), (?) dhe (?).

## Mikrogrimcat sekondare (?'')

Protonet e materialeve feromagnetike kur ndodhen në fushën magnetike, apo në kontakt të drejtpërdrejtë me polet magnetike të një magneti apo elektromagneti, pranojnë një pjesë të energjisë dhe kalojnë në një nivel energjetik më të lartë në vlerën (X) n i cili varet nga fluksi i i fushës magnetike (??), (??) dhe (??). Në këtë rast protonet e pllakës së hekurit kalojnë në vetërigjenarator, dhe nga to burojnë mikrogrimca (?''). Niveli i energjetik i mikrogrimcave (?'') është shumë më i ulët se niveli energjetik i mikrogrimcave (?). Këto mikrogrimca (?'') burojnë nga poli magnetik (?'') dhe shpërndahen në të gjitha anët.

Por vlen të theksohet se këto mikrogrimca (?'') që burojnë nga poli (?''f) e materialeve feromagnetike në brendinë e tyre përmbajnë nga dy fusha magnetike, (?f?'') dhe (?f?'') që kanë drejtime të kundërta.

## Mikrogrimcat sekondare (?'')

Gjithashtu edhe elektronet e materialeve feromagnetike kur ndodhen në fushat magnetike, apo në kontakt me polet magnetike, pranojnë një pjesë të energjisë, dhe kalojnë në një nivel energjetik më të lartë në vlerën (y) n i cili varet nga fluksi i fushës magnetike (??), (??) dhe (??).

Niveli i energjetik i mikrogrimcave (?'') është shumë më i ulët se niveli energjetik i elektroneve të materialeve feromagnetike (?). Këto mikrogrimca (?'') burojnë nga poli magnetik (?f'') dhe shpërndahen ngjashëm sikur mikrogrimcat (?'') në të gjitha anët. Por vlen të theksohet se këto mikrogrimca (?'') që burojnë nga polet (?''f) të materialeve feromagnetike në brendinë e tyre përmbajnë nga dy fusha antimagnetike. Kështu dipoli magnetik (?'') përmban dy fusha antimagnetike (?f?'') dhe (?f?'') që kanë drejtime të kundërta.

## Mikrogrimcat sekondare (?'') ni

Ngjashëm sikur në dy rastet e mëparshme edhe fenomenet te neutronet kur pranojnë energji të caktuar nga fusha magnetike apo kontakti i drejtpërdrejtë me polet magnetike, e rrisin nivelin energjetik në vlerën (z) n . Në këtë mënyrë këto neutrone shndërrohen në vetërigjenerator, dhe fillojnë të prodhojnë mikrogrimca (?''), të cilat ndryshojnë tërësisht nga mikrogrimacat (?'') dhe (?'').

Pasi neutronet janë neutrale, për shkak të nivelit të ulët energjetik të fenomeneve brenda strukturës së neutroneve, dhe rrotullimin e fenomeneve (ct) në drejtime të njëjta, nuk mund të quhen dipole magnetike. Por kanë mjaft ndikim te fushat magnetike, sepse e rrisin shpejtësinë e daljes nga të dy polet magnetike të pllakave të hekurit (?''f) dhe (?''f) të mikrogrimcave (?'') dhe (?''). Meqenëse këto mikrogrimca (?'') nuk janë të ngarkuara, dhe nuk posedojnë fusha në vete, prapë se prapë duke pasur parasysh se në brendinë e tyre posedojnë elemente (-aX) dhe (-aY) të kundërta me fenomenet (ct) të protoneve dhe elektroneve, kur dalin jashtë polit magnetik (?f'') i rrisin distancat e tyre me mikrogrimcat (?'') he (?'').

## Fusha antimagnetike simetrike

Fusha antimagnetike ishte sqaruar gjithashtu në botimet te (epoka e re 2019). Mirëpo pasi tani kemi të bëjmë me fushën magnetike simetrike, e cila buron nga të dy polet (?1) dhe (?2) të magnetit janë të nevojshme disa plotësime që kanë të bëjmë me rrjedhjen e fluksit e fushës antimagnetike simetrike. Në momentin kur pllakat e hekurit (a) dhe (b) vendosen mbi polet e magnetit (M) protonet, elektronet dhe neutronet nën veprimin fluksit të fushës magnetike (??) dhe (??), pranojnë energji dhe e rrisin nivelin energjetik të tyre. Në këtë rast këto protone, elektrone dhe neutrone kalojnë në grimca vetërigjeneruese. Duke u bazuar në mënyrën e magnetizimit artificial të magnetëve permanent që vendosen në fushën magnetike të solenoidit, shihet se mikrogrimcat që burojnë nga protonet, neutronet në njërën anë dhe elektronet në anën tjetër orientohen në drejtime të kundërta drejt poleve magnetike. Kështu që këtë për shkak të forcës tërheqëse dhe shtytëse, dhe niveleve të ndryshme energjetike, në mes mikrogrimcave (?), (?) dhe (?) që burojnë nga polet magnetike (?1) dhe (?2), dhe mikrogrimcave (?''), (?'') dhe (?'') që ndodhen në të dy pllakat e hekurit (a) dhe (b), këto të fundit shndërrohen në pengesa të pakalueshme për flukset fushave magnetike në të dy polet e magnetit.

Në këto rrethana kur mikrogrimcave (?), (?) dhe (?) ju pamundësohet dalja nga polet magnetike (?1) dhe (?2) kjo ndikon në rritjen e presionit të brendshëm të tyre, i cili presion në një formë e vështirëson daljen e këtyre mikrogrimcave nga protonet, elektronet dhe neutronet vetërigjeneruese. Pasi efekti i rigjenerimit te këto grimca nuk mund të ndalet, kjo e rritë edhe më shumë nivelin energjitik të protoneve, elektroneve dhe neutroneve në (x,y,z) (n+n), të cilat jo që e ngadalësojnë procesin e rigjenerimit por e ngritin në një nivel më të lartë.

Në këto rrethana, kur ndryshon niveli energjetik te këto grimca, ndryshojnë edhe lloji i mikrogrimcave që burojnë nga to, si dhe shndërrohen në vetërigjenerues të mikrogrimcave (?'), (?') dhe (?') që kanë një nivel energjetik shumë më të lartë se mikrogrimcat (?), (?) dhe (?). Në këtë mënyrë mikrogrimcave (?'), (?') dhe (?') nuk u mbetet asnjë alternativë tjetër pos të dalin dhunshëm jashtë poleve magnetike, do të thotë të dalin nga pjesa anësore e magnetit, ashtu sikur është cekur edhe në botimet e ("Epoka e re" 2019).

Në këtë mënyrë tërë fluksi i fushës magnetike nga të dy polet e magnetit sa e kishte lerën e ???=4.9 x10 -4 Wb rikthehet në fushën antimagnetike e cila e ka vlerën ??'?'=4.9 x10 -4 Wb. Po të bëhet një krahasim me fluksin e fushës magnetike që buron nga sipërfaqja e pllakave të hekurit në vlerën e ??''?''= 7.48x10 -5 Wb rezulton se fluksi i fushës antimagnetike është për 6.55 here më i lartë se fluksi i fushës magnetike.

## Mikrogrimcat (?'), (?') dhe (?')

Mikrogrimcat (?'), (?') dhe (?') janë të ndryshme nga mikrogrimcat (?), (?) dhe (?) dhe (?''), (?'') dhe (?''), sepse protonet, elektronet dhe neutronet i prodhojnë këto mikrogrimca atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e magnetit mbulohen me materiale feromagnetike. Edhe pse këto mikrogrimca burojnë nga pjesa anësore e magnetit shpërndahen në të gjitha anët duke formuar një formë sferike rreth magnetit me një rreze të caktuar (R) e cila varet nga niveli energjetik i mikrogrimcave (?'), (?') dhe (?'), dhe kohës së qëndrimit të materialeve feromagnetike mbi polet magnetike. (VIJON)




Fig 15

## Maas paralajmëron kundër një largimi masiv të hebrenjve



FRANKFURT, 26 JANAR - Hebrenjtë do të largohen në mënyrë masive nga Gjermania nëse nuk bëhet asgjë për të luftuar kundër rritjes së antisemitizmit, theksoi të dielën ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Heiko Maas. "Ne duhet të marrim masa urgjente për të shmangur një largim masiv të hebrenjve nga Gjermania", deklaroi Mass, sipas një artikulli të "Spiegel, një ditë para 75-vjetorit të çlirimit të kampit të Aushvicit. "Një në dy hebrenj ka parashikuar të largohet nga vendi", nënvizoi ai duke theksuar se fyerjet dhe sulmet antisemite ndodhin çdo ditë në Gjermani. "Lufta kundër antisemitizmit do të jetë një prioritet në Gjermani, që merr presidencën e radhës së Bashkimit Evropian në korrik dhe presidencën e Këshillit të Evropës në nëntor", tha Maas.

# Java e parë e gjyqit ndaj presidentit Donald Trump

Pasi java e parë e gjyqit ndaj presidentit në Senat u mbyll të shtunën, avokatët e presidentit kanë tri ditë kohë për të argumentuar para 100 senatorëve të cilët do të vendosin për largimin ose jo nga detyra të presidentit Donald Trump



UASHINGTON, 26 JANAR - Java e parë e gjyqit ndaj presidentit Donald Trump në Senat u mbyll të shtunën, ndërsa avokatët e presidentit filluan mbrojtjen e tij, duke argumentuar se presidenti nuk kishte bërë asnjë gabim në komunikimet e tij me Ukrainën. Ekipi i avokatëve mbrojtës ka tri ditë kohë për të argumentuar para 100 senatorëve të cilët do të vendosin për largimin ose jo nga detyra të presidentit Trump, ka njoftuar voa.

Në një ditë të shkurtër të shpalosjes së argumenteve fillestare, të përshkruar si një prezantim paraprak, avokatët e Shtëpisë së Bardhë sulmuan nga fronte të ndryshme demokratët. Së pari ata e quajtën të pabazë akuzën për shkarkimin e presidentit. "Demokratët akuzuan presidentin se përdori ndihmat për sigurinë për të detyruar presidentin Voldymyr Zelenskiy të njoftojë hapjen e hetimit ndaj djalit të ish-nënpresidentit Biden. Por si mund të jetë e mundur kjo kur ukrainasit nuk ishin në dijeni se ndihma e sigurisë ishte pezulluar? Nuk mund të ketë një kërcënim, nëse personi që po kërcënohet nuk e di. Nuk mund të ketë një ofrim të një favori, nëse favori nuk ekziston", tha Mike Purpura, avokat i Shtëpisë së Bardhë.

Avokatët e Shtëpisë së Bardhë argumentuan se presidenti ka kompetenca të gjera për vendimmarrje. "Mosrënia dakord me vendimet e presidentit për çështje të politikës së jashtme, ose mbi atë se nga kush i merr këshillat, nuk është një arsye për shkarkimin e tij", tha avokati i Shtëpisë së Bardhë, Jay Sekulow.

Avokatët e presidentit Trump kritikuan gjithashtu menaxherët e demokratë të gjyqit për hamendjet në lidhje me motivet e presidentit. "Kjo është e rreme. Kjo nuk është thirrja e vërtetë. Kjo nuk është provë. Ky nuk është transkripti i telefonatës", tha avokati Mike Purpura.

Demokratët thonë se problemi mund të zgjidhet me lehtësi nëse republikanët lejojnë paraqitjen e dëshmisë së dorës së parë që republikanët deri më tani kanë refuzuar ta bëjnë. "Përshtypja ime e fortë nga dy orët e para është se çështja e sjelljes së dëshmitarëve dhe dokumenteve është bërë edhe më e rëndësishme", tha senatori demokrat Tim Kaine.

Demokratët kanë kërkuar paraqitjen si dëshmitarë të disa zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të administratës, duke përfshirë ambasadorin John Bolton dhe shefin e Personelit të Shtëpisë së Bardhë, Mick Mulvaney, i cili u tha gazetarëve vitin e kaluar se pezullimi i ndihmës ishte i lidhur me kërkesat e presidentit. "Nëse kjo ishte me të vërtetë për luftimin e korrupsionit nga presidenti Donald Trump, atëherë pse e fshehu atë nga Kongresi? Pse nuk i thanë popullit amerikan se çfarë po bënin? Arsyeja që ata nuk e kanë njoftuar popullin amerikan është sepse ishte një kërcënim i korruptuar për t'i ndihmuar ata që të vidhnin zgjedhjet", tha ligjvënësi demokrat Adam Schiff, menaxher i gjyqit në senat.

Prezantimi dy orësh nga mbrojtja e presidentit Trump dukej se kishte më shumë efekt te republikanët sesa argumentet shumë më të gjatë të demokratëve. "Për 23 orë nuk dëgjuam asgjë përveç disa vogëlsirave dhe një këndvështrimi të vetëm. Në këto dy orë, unë mendoj se ata bënë më shumë përparim sesa tërësia e asaj që ata na vunë, me male informacioni, gjëra të vogla dhe thjesht nuk arritën në pikën e duhur", tha senatori republikan Mike Braun.

Gjyqi pritet të rifillojë të hënën me vazhdimin e paraqitjes së argumenteve nga avokatët mbrojtës të presidentit.

## Policia irakiane sulmon me armë protestuesit



BAGDAD, 26 JANAR - Të dielën forcat irakiane të sigurisë qëlluan me armë në një përpjekje për t'i shpërndarë protestuesit, duke plagosur disa prej tyre në kryeqytetin e vendit Bagdad si dhe qytetin Nasirija.

Një ditë më parë kleriku i njohur Muqafa al-Sadr bëri të ditur se nuk do t'i mbështesë më tubimet që po zhvillohen prej katër muajsh në Irak të cilat kanë kërcënuar status quo-në. Disa orë pas këtij vendimi njerëzit e al-Sadr, të cilët ishin ndër përkrahësit më të fortë të protestuesve, u larguan nga kampet me çadra, të ngritura në qendër të Bagdadit.

Protestuesit kërkojnë ndryshim të klasës politike, rritje të mundësive për punësim e kujdes shëndetësor, më shumë siguri si dhe dhënien fund të varfërisë ekstreme e korrupsionit që ka përfshirë vendin në shkallë të gjerë.

Protestuesit e kishin parashikuar se pa mbështetjen e klerikut a-Sadr, do të sulmoheshin nga milicia dhe divizione të forcave të sigurisë.

Prej fillimit të protestave në muajin tetor të paktën 600 veta janë vrarë dhe 20 mijë të tjerë janë plagosur.

# PIKËPAMJET E PROFESOR REXHEP QOSJES PËR ALBANOLOGJINË

Prof. asoc. dr. MYRVETE Dreshaj-Baliu
Prof. dr. Begzad BALIU

Abstrakti: Profesor Rexhep Qosja është albanolog në kuptimin e parë të këtij nocioni. Ai është njëri prej themeluesve të disa institucioneve albanologjike në Kosovë dhe konceptualizues i shumë proceseve e projekteve shkencore në kontekstin metodologjik, terminologjik e nocionor të tyre. Akademik Rexhep Qosja është historian i letërsisë shqipe dhe krijues i disa prej nocioneve e terminologjive themelore të saj, standardolog i gjuhës shqipe, kulturolog, historian dhe personaliteti më me ndikim në historinë e re shqiptare. Ai sot vlerësohet për kontributet e veçanta në fusha të caktuara të dijes, por në përmasën fundamentale të kontributeve të tij, ai mbetet njëri prej albanologëve më të shquar të shekullit XX dhe të këtij fillimshekulli që po e jetojmë. Duke qenë njëri prej studiuesve më të shquar të periudhës së romantizmit shqiptar dhe duke sjellë frymën homogjene të kësaj periudhe edhe në kohën më të re, Profesor Qosja me jetën dhe me veprën e tij nuk e përfaqëson vetëm idhullin e shqiptarizmës: Naim Frashërin, po sintezën e madhe të kësaj periudhe të lavdishme historike. Kjo, sigurisht është edhe arsyeja pse vepra e tij shkencore, letrare dhe politike e ka ndihmuar kalimin e popullit shqiptar në kapërcyell të shekullit XXI.

## I. Përvoja e madhe

I njohur si historian i letërsisë, estet, kritik letrar, publicist, prozator e dramaturg, polemist e gojëtar, Rexhep Qosja, në të gjitha këto fusha bosht kryesor kishte fjalën shqipe, gjuhën shqipe dhe fatin historik të saj, gjuhën e letërsisë, filozofinë dhe dimensionin historik e stilistik të saj, rolin e gjuhës në formimin identitar dhe mbrojtjen e albanologjisë e përmasën kombëtare të saj. Profesor Qosja u lind më 25 qershor 1936 në Vuthaj të Malit të Zi. Gjimnazin e mbaroi në Ivangrad, Normalen në Prishtinë, studimet i vazhdoi në Beograd, ndërsa doktoratën në Prishtinë. Ishte bashkëpunëtor, anëtar dhe drejtues i pothuajse të gjitha institucioneve arsimore, shkencore dhe kulturore të Kosovës nga vitet '60 e këndej. Gjatë këtyre dekadave të jetës së tij, nga Vuthaj në Ivangrad, Prishtinë, Mitrovicë e Beograd e përsëri në Prishtinë, Profesor Qosja trashëgoi kujtesën e dhimbshme të historisë së familjes së tij, të qenit në kufi dhe në konflikt të përhershëm me sllavët e jugut (ruajtur në nëntekstin e eposit që nga antikiteti i vonë), kujtesën e të qenit në kufirin fundor të Perandorisë Osmane në rënie dhe në shtetin e zgjatur të Perandorisë Ruse që po formohej; kujtesën për krenarinë epike të formuar nën paradigmën e eposit shqiptar dhe të teksteve letrare e historike të bardit të kombit shqiptar Gjergj Fishta; përmbajtjen estetike dhe historike të literaturës së sllavëve të jugut në Ivangrad dhe të letërsisë e filozofisë evropiane, para se gjithash, franceze, gjermane e ruse në Beograd etj.

Do të vijnë më tej dekadat e tjera kur Profesor Rexhep Qosja për më shumë se 50 vjet do të shquhet për angazhimin e tij krijues në botën intelektuale, shkencore, arsimore dhe kulturore e politike shqiptare. Me tekstet e tij metodologjikisht antidogmatike, me gjuhën e tij polemizuese, me mendimin e tij kritik, e largvajtës, me konceptet bashkëkohore të njohjes, fillimisht në fushë të mendimit kritik e më tej edhe mendimit kulturor, shkencor, historiko-letrar dhe politik, Rexhep Qosja, ka sjellë kurdoherë diskutime të gjera e të thella në opinionin e kohës. Veprat e tij me karakter teorik, historik, filozofik, estetik, antropologjik, historiko-letrar e kulturor dhe më në fund edhe ditari "Dëshmitar në kohë historike", reflektojnë për angazhimet e tij në jetën qytetare, kulturore dhe institucionale të kohës, që më parë se sa prej koncepteve ideologjike të pranishme dendur në Prishtinë dhe mbretëruese në Tiranë, sundoheshin prej veprave të filozofëve klasikë: Zhan Zhak Rusosë, Erazmo Roterdamit, Konfuçies, Dëni Didrosë, Emanuel Kantit dhe filozofëve bashkëkohorë të kohës: Zhan Pol Sartrit, Klod Levi Strosit, Roland Bartit, Lui Benlevit, Anri Bergsonit, Roman Jakobsonit, Volflang Kajzerit, Soren Kjerkegorit, Ernst Robert Kurtiusit, Lesingut, Jurij Lotmanit, Sanktisit, Romen Rolanit, Fransua Shatabrianit, Ipolit Tenit, Filipvan Tigemit, Zhak Derridas etj; si dhe prej veprave të letërsisë së përbotshme (Eskilit, Dantes, Shekspirit, Gëtes etj.), por me referencë majat e letërsisë moderne europiane, ruse dhe amerikane: Dostojevskin, Marsel Prustin, Xhems Xhojsin, Uilliam Foknerin, Albert Kamyn etj. Veprat shkencore dhe letrare, dhe për më tej ditari, dëshmojnë për formimin e tij shkencor, letrar dhe intelektual pikërisht në këtë periudhë të pesë dekadave të para të jetës së tij. Nuk është e rastit prandaj pse që në periudhën e parë të veprimtarisë së tij shkencore do të zënë vend neologjizma, nocione e terma letrarë, historiko-letrarë e filozofikë, estetikë e antropologjikë, të cilët deri atëherë u kishin munguar letrave shqipe: estetika e imagjinuar, estetika e tejkaluar, hierarkia e kuptimit, kompozicioni i zgjeruar, paradokset e mitit, ekzotika e dialogut, struktura e rrjedhave, polisemia e tekstit, paradigmat e kritikës, semantika e rrudhur, poetika e konit, teori e iluzioneve, monologu i dialogizuar, ligjërimi oratorik etj. Duke u mbështetur në arritjet e gjeratëhershme të përvojës evropiane të filozofëve, gjuhëtarëve, letrarëve e antropologëve të kohës, qasjet teorike të tyre, në tekstet e tij kritike, letrare e historiko-letrare, filozofike e antropologjike, Profesor Qosja insistonte në përcaktimin e metodave moderne shkencore të kritikës, studimit të letërsisë, përcaktimit të koncepteve, nocioneve e termave të gjuhës letrare dhe të gjuhësisë së zbatuar, në të vërtetë, në përcaktimin e pluralizmit të metodave, si kusht për të çliruar gjuhën, kritikën, historinë, folklorin, letërsinë dhe shkencën e saj nga dogmatizmi. "T'i kishim të zhvilluara, të themi, kritikën filozofike, (mjerisht s'kemi akoma njerëz që mund ta shkruajnë), kritikën linguistike, kritikën stilistike, kritikën marksiste, kritikën tematike, kritikën strukturaliste, kritikën receptive, kritikën formaliste, e të tjera, që i thellojnë aspektet formale të fenomeneve artistike, do të ishte aq më mirë për krijimtarinë dhe kulturën tonë".




## II. Çështje të studimit: pluralizmi i metodave

Në këtë rrjedhë ai kontribuoi në ngritjen e shkollës letrare të ndërtuar mbi poetikën strukturale historike. Duke bërë një përmbledhje të arritjeve më të mira në fushë të studimit të letërsisë shqipe në institucionet universitare dhe shkencore në Prishtinë (1981), Profesor Qosja theksonte se "një numër i magjistrantëve janë orientuar në hetimin e të dhënave themelore për autorë, për vepra, për periudha letrare, që është kusht i studimeve të mëtejme, kurse numri tjetër, më i madh, janë orientuar në hetimin e strukturave të kësaj letërsie në sinkroninë dhe në diakroninë e saj. Theksi i specializimit shkencor historiko-letrar në studimet e shkallës së tretë të Degës së Letërsisë Shqipe, pothuaj, prej fillimit vihet mbi hetimin e poetikës strukturale historike të kësaj letërsie, të poetikës së autorëve të veçantë, të poetikës së zhanreve dhe të poetikës së periudhave, me ç'rast në nocionin poetikë (strukturale) historike, përpos çështjeve të njohura me të cilat sot merret poetika, inkuadrojmë edhe hetimin e semantikës së veprës, në njërën anë dhe të strukturës së procesit të zhvillimit historiko-letrar, në anën tjetër. Mendoj se sintezat e ardhme të letërsisë shqipe, para së gjithash, duhet të bazohen mbi studimin e poetikës strukturale historike të kësaj letërsie".

Nëse në periudhën e parë, kryesisht deri në vitet '80, kur ai përgatit për botim sintezën Tri mënyrat e shkrimit shqip (1979), nocionet dhe termat shfaqen më gjerësisht dhe më shumanshëm në përmasa letrare, shkencore, teorike dhe socioletrare, në periudhën e dytë, e cila kurorëzohet me projektin e madh Historia e letërsisë shqipe (Romantizimi I, II, III), 1984-1986, ato marrin dhe shquhen edhe për shqipërimin e tyre, për neologjizmin e tyre dhe më në fund për krijimin e nocioneve dhe termave të rinj. Në vëllimet e kësaj sinteze të madhe dhe në veprat e kësaj periudhe me karakter historiko-letrar, historik, polemizues, e antropologjik: Porosia e madhe (1986), Populli i ndaluar (1990), Çështja shqiptare - historia dhe politika (1994), Ligjërime paravajtëse (1996), Fjalor demokratik (1997), Paqja e përgjakshme (1999), Tronditja e shekullit I, II (2001), Shpërngulja e shqiptarëve sipas programeve kombëtare serbe (2005), Ideologjia e shpërbërjes (2006), Rilindja e dytë (2007), Semantika e ndryshimeve historiko-letrare (2009), etj., si dhe në ditarët e tij Dëshmitar në kohë historike, I-VII (2014-1916), do të shquhet për zgjerimin e horizontit të fjalësit të nocioneve, termave dhe togfjalëshave gjuhësorë, letrarë e historikë në dijen albanologjike. Në tekstet gjuhësore e historike, letrare e historiko-letrare, kulturore, sociologjike e antropologjike, të botuara në shtypin ditor e ditoror, në intervista ditore apo të lexuara në konferenca shkencore, veç tjerash do të shqyhet edhe për nocionet, termat, togfjalëshat dhe neologjizmat, të cilat që më parë ishin shquar në veprën monumentale Historia e letërsisë shqipe: aforizmi - por edhe aforizmi i poetizuar; dialogu - por edhe dialogu i rrëfyer, estetizmi i gjuhës, estetizmi i historisë, europeizimi, figura e mendimit, fjalia çuditëse, fjalia pohore, foljezimi, funksioni kumtues, gjedha (modeli), gjuha diturore, gjuha nocionore, gjuha zmadhuese, kritika receptive dhe horizonti i pritjes (Jaus), kritika e rekonstruksionit, kritika e çndërtimit (Zhak Derrida); pluralizmi metodologjik, ortodoksizmi ideologjik, dogmatizmi ose stalinizmi, jetëshkrimi, kallëzimi mitologjik, letra-ese, lidhja jashtëtekstore, ligjërimi thirror, metagjuha iluministe, metagjuha romantike, modeli tingullor, nënteksti, njësia gjymtyrore, parastandardizimi (i gjuhës), përbashkësia e stileve, përbërësi dialektor, përkushtimi gjuhësor, procedimi stilistik, pyetja retorike, ritmi gjymtyror, rrafshi shqiptimor, rrafshi theksor, simetrizimimetriko-ritmik, sprova, stili epokës, stili hiperbolizues, struktura kohore, struktura retorike e tekstit, struktura theksore, shkalla sipërore, shqiptimi solemn, tendosja ritmike, tërësia theksore, thënia habitore, thënia sugjestive, thjeshtligjërimi, vetërrëfimi, visorja, visorja ideale, vjersha ëndërr, vjersha profeci, zotëruesja, zotëruesja rrokjesore etj. Le të theksojmë se fjala është për termat, nocionet, neologjizmat dhe togfjalëshat me të cilat Profesor Qosja ka studiuar dhe ka shpjeguar poetikën e letërsisë së romantizmit. Po të vazhdonin të hulumtonim termat dhe nocionet me të cilat Profesor Qosja ka studiuar disa aspekte të letërsisë së vjetër, të letërsisë së periudhës prej romantizmit deri te realizimi, të letërsisë së realizimit dhe letërsisë bashkëkohore, rrafshi i tyre do të ishte shumë më i gjerë, shumë më i pasur dhe shumë më i dendur.

Meqenëse objekt ynë në këtë studim është profili i Profesor Qosjes prej albanologu, temës sonë po i qasemi duke u nisur nga tri sprova bazë: Studimet albanologjike dhe institucionet e tyre, botuar së pari në gazetën Rilindja, më 28-29. IV. 1969; Mbledhja e lëndës dhe sintezat shkencore, fjalë rasti në shënimin e 10-vjetorit të Institutit Albanologjik, më 16. XII. 1977, si dhe në sintezën Studimet albanologjike në perspektivën evropiane, fjalë rasti në mbledhjen kushtuar problemeve të studimeve albanologjike, mbajtur në Institutin Albanologjik, më 18. IV. 1981. Fjala është, veç tjerash, për shtatë konceptet e Profesor Qosjes për organizimin e studimeve albanologjike, kërkesa që "të diskutohet mundësia e hartimit të enciklopedisë shqiptare" (1969) dhe disa prej projekteve të tij, të cilat për fat të keq nuk po arrijmë t'i sendërtojmë as sot, kur kushtet institucionale, praktike, teorike dhe teknologjike sjellin shumë më shumë hapësirë sot, seç mund të sillnin në vitin 1969, 1977 dhe 1981, kur i projektonte Profesor Qosja. **(VIJON)**

# PËRMASA MË SHUMË SE PERSONALE TË NJË RRËFIMI TË SINQERTË



Jakup KRASNIQI

Kam nderin të flas para jush për dy libra që po promovohen sot të njeriut me të cilin më lidhi rruga jetësore, qoftë në rininë e hershme, në formimin intelektual e atdhetar që në bankat e shkollës normale, ku përgatiteshim për profesionin fisnik të mësuesit, në veprimtarinë klandestine, në hetuesi, në burgje, për të kulmuar pastaj në zhvillime të tjera aspak të lehta me ndryshimet që ndodhën në gjithë Evropën, por për ne, brezin tonë, degën e ndarë padrejtësisht nga trungu që nga viti 1912/13, ishin të një rëndësie të veçantë dhe padyshim që sollën ndryshimin.

Të dy librat që kemi përpara, rrëfimet "Shenja e përkatësisë" dhe kujtimet "Burg pas burgu" dëshmojnë përkushtimin e autorit për të treguar ç'duhej thënë e treguar për brezat. Për ta rrëfyer frymën që formoi personalitetin e secilës frymë do t'i përkushtojë një jetë të tërë. I dhembshëm është fakti se për të gjallë autori arriti të botonte vetëm librin monumental të ilegales së viteve shtatëdhjetë: "Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës", në bashkautorësi me Mehmet Hajrizin, botim i vitit 2014, por që gëzon fakti se ai la pas këta dy libra pothuajse të gatshëm për botim dhe, sa jam i informuar, jo pak shkrime lënë në dorëshkrim që presin të botohen.

Latinët e lashtë kanë thënë me të drejtë "Ars longa, vita brevis", "arti i gjatë, jeta e shkurtër", sikundër dhe "Verba volant, scripta manent", "fjalët i merr era, shkrimi mbetet" që aq bukur korrespondojnë me punën intelektuale që na la trashëgim Ganiu. Që nga Lidhja e Prizrenit, po veçanërisht nga copëtimi i trojeve shqiptare pas 1912/13-s dhe premtimet për një vëllazërim-bashkim imagjinar e kurrë të jetësuar nga 1945-ta breza të tërë nuk hezituan, përkundër çmimit të lartë që duhej paguar për aspirata liridashëse, të çlirimit e të bashkimit kombëtar. Me të drejtë thuhet: "Të luftosh mund edhe të humbësh, por, pa luftuar nuk ka fitore". Këtë frymë na sjellin librat që po i promovojmë sot.

Pikërisht këta dy libra dëshmojnë se me ç'sakrificë u formuan dhe vepruan bijtë dhe bijat e gjakut shqiptar për fitoren përfundimtare.

"Shenja e përkatësisë" shpalos Ganiun në gjithë përmasën e formimit dhe të veprimit. Një rrëfim i sinqertë nga faqja në faqe, nga ngjarja në ngjarje, nga organizimi në organizim.

Një rrëfim në veten e parë, po që kalon përmasat e individuales, sepse e tillë ishte jeta e secilit nga ne që aspironim lirinë, barazinë pse jo edhe bashkimin e kombit sikur gjithë popujt e qytetëruar.

Është Drenica, vendi i formimit dhe i sakrificës, e djegur dhe e shkallmuar aq rëndë dhe padrejtësisht siç ndodhi në shekullin e kaluar, një gjenocid, së këndejmi një etnocid i pashembullt në Evropën dhe Perëndimin Demokratik. Etnocidi është gjenocidi, një vrasje e një kulture e kombi dhe e shpirtrave individualë. Kjo i ndodhi kulturës shqiptare e bartësve të saj jo vetëm në Drenicë, por në të gjitha trojet shqiptare jashtë Shqipërisë politike, të ndarë e copëtuar si mos më keq në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës e gjetiu.

Së këndejmi "Shenja e përkatësisë" e Ganiut përçon një frymë dhe një qëndresë në rrethana sot madje të paimagjinueshme.

Libri i dytë, "Burg pas burgu", është një nga librat e rrallë me tematikë qendrore për jetën e burgut, skenat dhe prapaskenat, dhuna dhe terrori i paparë ndaj individit në ndjekjen, burgosjen, procesin e rëndë të hetuesisë, gjyqi, ditët, muajt, vitet në qeli, procese e dënime të pamjaftueshme për shtetin policor që e tmerronin idetë revolucionare për lirinë e shtetin, brezi që nuk donte t'ia dinte për tortura e masa të tjera të terrorit fizik e psikik.

Jam i bindur se secili lexues, duke shfletuar këtë libër do të bindet se çfarë ishte një shtet i huaj dhe si veproi me pjesën më të vetëdijesuar të një populli liridashës, rininë e tij dhe jo vetëm të tijen.

Po, me Ganiun nisëm rrugën jetësore aspak të lehtë për kohën, atë të mësuesisë dhe kjo koinçidoi me 1968-n, 500-vjetorin e vdekjes së kryeheroit shqiptar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, që do të ngjallte frymën e pandalshme për çlirim e bashkim.

Në gjithë librin do të gjeni një detaj shumë të rëndësishëm: librat. Ato ishin pjesë e pandarë e aktiviteti kalndestin, por edhe e jetës në vetmi, qelisë, burgjeve, qoftë në Prishtinë, në Shkup, në Mitrovicë apo në Sombor

Ne, që kemi qenë me vite në këto burgje e dimë ç'do të thotë libri në vetminë e thellë. Në torturat dhe ndalesat më çnjerëzore, edhe pse ai shtet që do të falimentonte, proklamohej si vend i hapur dhe më liberali ndër shtetet ish-komuniste. . Bota kishte parë djegien e librave, regjimi i Titos e pas tij, i burgosnin librat dhe lexuesit e tyre.

Secili lexues, duke shfletuar e lexuar këtë libër, librin "Burg pas burgu", do të mësojë ç'rëndësi ka familja, miqtë, shokët e ilegales të cilët me asnjë çmim nuk zbulohen, duke kulmuar me ngadhënjimin e së drejtës, e idealit dhe aspiratave shekullore liridashëse.

Proceset gjyqësore që organizoheshin ndaj shqiptarëve ishin një farsë e sistemit të kalbur, por që me dënimet drastike synohej frikësimi i një populli të tërë, një popull që ishte i burgosur si ata bijë dhe bija prapa grilave, si ata që u mohoheshin të drejtat më elementare. Në këtë libër Ganiu ka konfirmuar se njeriu në kohë të vështira e shpërfaqë integritetin e tij, dinjitetin e tij dhe moralin e tij njerëzor.

Është e habitshme sesi nganjëherë, përftoj nga rasti ta them këtë, abuzohet me besimin që kishim në literaturën që qarkullonte qoftë legalisht, qoftë ilegalisht me tituj dhe retorikë mbase edhe demagogjike, shikuar nga e sotmja, si ajo e Leninit "Mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje"! Por ne i besuam dhe iu përkushtuam kësaj rruge dhe ideje deri në frymën e fundit.

Në fund të shekullit në shkuarje dhe fillim të shekullit në ardhje, Vetëvendosëm me armën e fundit të politikës, me luftën Çlirimtare.

Përgëzime familjes dhe botuesit për librat dhe një falënderim postmortem për Ganiun për këta dy libra që na i ka lënë, që ne t'i lexojmë e shkruajmë për to!

Qoftë i përjetshëm kujtimi për Gani Sylajn!



E jashtëzakonshme

# Postierit i gjenden 24 000 letra të pashpërndara në shtëpi



Një postier në Japoni akuzohet për shpërdorim detyre pasi nuk ka dorëzuar me mijëra letra postare në destinacion. Gjatë një operacioni të policisë në shtëpinë e tij u gjetën 24 mijë letra postare, që dyshohet se i kishte fshehur që prej vitit 2003. 61-vjeçari ishte një prej përgjegjësve të shpërndarjes së postës, ndërkohë që ka deklaruar si ishte e mërzitshme t'i dorëzojë të gjitha letrat. Zyra postare e Yokohamas u kërkoi falje qytetarëve dhe u premtoi se ato do të shpërndahen. Nëse do të ngrihet aktakuza, postieri pritet të dënohet me tre vjet burgim dhe rreth 3 500 euro gjobë.

FOTO E DITES




Ekskavatorët shihen duke punuar në ndërtimin e një spitali të ri në Kinë pas shpërthimit të virusit në Wuhan. /AFP/

E rrallë

# Fermerët japonezë krijojnë punime mbresëlënëse 3D në fushat e mbjella me oriz



Në fushat e mbjella me oriz në Japoni janë krijuar punime të ndryshme 3D që japin pamje shumë mbresëlënëse. Për t;i punuar këto ilustrime fermerët nuk përdorin ngjyra, por iu duhet të mbjellin varietete të ndryshme orizi, qëkur të rriten të krijojnë figura të caktuara. Janë rreth 15 mijë metra katrorë me fusha të mbjella në pjesën rurale të Inakadate të Aomori të Japonisë, që mbulohet me këto ilustrime të rritura në mënyrë natyrale. Nga rrafshina këto punime janë të padukshme, por nëse hipet mbi ndonjë ndërtesë, apo fotografimet me dron shfaqin pamjet e mahnitshme që shihen në fushë.

## BARSOLETA E DITËS



**Pacienti: Doktor, prej se jam martuar nuk po shoh mirë.**
**Doktori: Çfarë s'po sheh, saktësisht?**
**Pacienti: Paratë nuk po i shoh se kah po shkojnë!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 18:00**

### Spies in Disguise 3D




I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




**Në ora 18:00**

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
**Regjia:** Jake Kasdan

**Çdo natë në ora 20:00**

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
**Regjia:** J.J. Abrams




**Çdo natë në ora 22:30**

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
E diel shumë e këndshme, veçanërisht nëse jeni duke planifikuar një udhëtim ose pushime. Nëse qëndroni në shtëpi, telefonatat, përgjigjet ose zgjidhjet të cilat mezi i keni pritur mund të vijnë.



**DEMI**
Gropat dhe problemet praktike kërkojnë vëmendjen tuaj. Mos bini pre e mashtrimeve. Meditoni për ide dhe projekte që duken të pamundura për t'u bërë tani.



**BINJAKËT**
Sot do t'ju tërheqin interesat e reja, për njerëzit nga mjedise ndryshe nga ato të zakonshme. Ju ndiheni ndryshe jo si zakonisht dhe kjo do t'ju largojë nga rutina e përditshme.



**GAFORRJA**
Do të përballeni me përvoja dhe emocione të reja. Jini të qetë dhe të lumtur nëse jeni në çift dhe kini një besim të fortë!



**LUANI**
Qielli gri për Luanin, për shkak të Hënës në Ujori, përballë shenjës. Hëna do t'ju prishë një program të shumëpritur të ditës dhe do ta ulë humorin tuaj në zero.



**VIRGJËRESHA**
Do t'ju hapen rrugë për ambiente të reja dhe njerëz të rinj gjatë gjithë javës së ardhshme.



**PESHORJA**
Do të merrni ftesa dhe do të keni mundësi të keni një jetë të gjallë dhe përmbushëse shoqërore.



**AKREPI**
Duket një mision i pamundur për të gjetur një qetësi të vogël në marrëdhënie si një çift historik. Pasdite dhe mbrëmje shumë e këndshme në shoqërinë e miqve të përhershëm.



**SHIGJETARI**
Koha e mirë për të planifikuar operacione komplekse, veçanërisht nëse ata përfshijnë njerëz të tjerë: Fati do t'ju shoqërojë në bizneset tuaja!



**BRICJAPI**
Filloni menjëherë, Hëna dhe Mërkuri janë më të mirat për marrëveshje, vepra të shkruara, shitje dhe blerje të ndryshme.



**UJORI**
Nëse kohët e fundit keni filluar një histori sentimentale, por synoni ta bëni atë zyrtare, është mundësia e duhur për ta prezantuar partnerin tuaj me miqtë dhe të afërmit.



PESHQIT
Përvishni mëngët pa u ankuar dhe përpiquni t'ia dilni mbanë! Trupi i njeriut është një mekanizëm i përsosur, përveç se disa zakone shumë jo të shëndetshme ndryshkin ingranazhet e tij.

# Penelope Cruz shfaqet tejet elegante



Ajo është një aktore e famshme, e cila ka qenë pjesë e filmave të njohur. Penelope Cruz dukej tejet elegante në paraqitjen e fundit në ndarjen e çmimeve 'Goya Awards' në Spanjë. 45-vjeçarja ishte nominuar në kategorinë për 'Aktoren më të mirë', për rolin e saj në filmin "Pain and Glory". Cruz ka shkëlqyer e veshur me një fustan të purpurt i cili ishte i zbukuruar me lule delikate.

# Fustani i Beyonces është dizajnuar nga Valdrin Sahiti



Këngëtarja e njohur botërore, Beyonce, ishte pjesëmarrëse në Pre Grammy Gala të organizuar nga producenti i njohur amerikan, Clive Davis, aty ishin të pranishëm yje të shumta botërore. Beynonce pati të veshur një fustan elegant me ngjyrë të kuqe të cilin e kishte të dizajnuar nga Valdrin Sahiti. E njëjta këngëtare para një muaji kishte veshur një fustan të dizajnuar nga Kujta dhe Meri, të cilin e pati të veshur në ditëlindjen e këngëtari Drake.



# Dua Lipa shoqërohet nga i dashuri në Pre-Grammy Gala

Këngëtarja kosovare Dua Lipa dhe modeli Anwar Hadid janë bashkë që nga korriku i vitit të kaluar. Ata ishin nën shoqërimin e njëri-tjetrit në ngjarjen Pre-Grammy Gala të producentit të famshëm amerikan Clive Davis, si ky event mbahen edhe disa të tjerë të cilët i paraprijnë Grammy Awards 2020. 24-vjeçarja pati të veshur një xhaketë ngjyrë të zezë me material të lëkurës të shoqëruar me një palë çizme të gjata. Ndërsa i dashuri i saj pati të veshur një këmishë të bardhë dhe pantallona ngjyrë hiri. Lipa vitin e kaluar ishte shqiptarja e parë që pati fituar ndonjëherë çmime Grammy, këtë vit ajo nuk është e dominuar në asnjë kategori.

# Jessie J e konfirmon ribashkimin me Channing Tatum

Këngëtarja e njohur, Jessie J, e ka konfirmuar ribashkimin e saj me aktorin Channing Tatum. Ajo me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram" ka shkruar se dashuria e saj për Tatum rritet vazhdimisht në mënyra të ndryshme. "Lumturi çdo kund brenda dhe jashtë. Unë të dua ty shumë i dashur. Mënyra që më do ti mua dhe unë ty, dhe si ndihemi ne, janë më të rëndësishmet", ka shkruar Jessie. Në videon e publikuar ata të dy shihen duke e puthur njëri-tjetrin.






Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Dushi: U pensionova për shkak të bashkimit me familje në Gjermani

Nikollë Dushi nuk do të shkelë më nëpër terrenet e fushave të futbollit në Kosovë pasi ai ka vendosur që të pensionohet nga loja e futbollit dhe ta vazhdojë jetë në Gjermani. Ish-lojtari i Prishtinës ka bërë me dije për "Epokën e re" se lojës së futbollit nuk do t'i ndahet as në shtetin gjerman



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 26 janar** - Nikollë Dushi ka vendosur të pensionohet nga loja e futbollit në kohën kur ishte në formë shumë të lartë. Sulmuesi ishte lojtari kryesor i Malishevës në Ligën e Parë, por ai vendosi të braktisë këtë skuadër dhe futbollin e Kosovës për ta vazhduar karrierën dhe jetën në Gjermani. "Them të drejtën, po të mos largohesha nga Kosova do të vazhdoja ende të luaja futboll, por mora vendim që të pensionohem para kohe për shkak se tash e tutje do të jetoj në Gjermani. Atje do të punoj dhe të merrem edhe me futboll, sepse me këtë lojë jam rritur dhe asnjëherë nuk do t'i ndahem futbollit", ka thënë Dushi.

Sulmuesi që bëri karrierë në shumë klube të Kosovës në sezonin vjeshtor shënoi 10 gola për klubin e Malishevës në Ligën e Parë dhe falë golave të Dushit, kjo skuadër përfundoi në vendin e katërt me 26 pikë të grumbulluara, dy pikë me pak se Besa që është lidere dhe, përveç këtyre dy klubeve, në garë për t'u inkuadruar në Superligë janë edhe Arbëria, Liria dhe Istogu. "Tash jam 33-vjeçar dhe në sezonin vjeshtor kam treguar formë të lartë, ku kam realizuar edhe 10 gola. Nga futbolli i Kosovës nuk jam larguar për shkak të kushteve, por për familje. Normalisht se jam i lumtur me rezultatet e klubit dhe pozitën që e kam lënë, por i mërzitur që nuk kam mundur t'i ndihmoj edhe në pranverë", ka shtuar ai.

Dushi ka shtuar se çastet më të mira në karrierën e tij i kaloi në klubin e Prishtinës dhe Malishevës. "Të them të drejtën, në të gjitha klubet ku kam luajtur kam kaluar dhe jam ndier mirë, kurse formën më të mirë e kam pasur në Klubin e Prishtinës, ku kam fituar çdo titull, por edhe me Malishevën jemi bërë kampionë në Ligën e Dytë dhe kam qenë golashënuesi më i mirë, kurse edhe në këtë edicion rezultatet pozitive nuk kanë munguar", ka shtuar ai.

Përveç Malishevës dhe Prishtinës, Dushi ishte pjesë edhe e Vëllaznimit, Hajvalisë dhe Fushë-Kosovës. Nikollë Dushi është shpallur edhe sportisti i vitit 2019 në Komunën e Malishevës, pas sukseseve që arriti me skuadrën nga ky qytet në sezonin vjeshtor.

## SHKURT

### Kullashi i argjendtë në Itali, lëndohet Zekaj

Xhudisti Arbër Kullashi ka rrëmbyer medaljen e argjendtë në turneun ndërkombëtar të mbajtur Alpe Adria në Lignano të Italisë. Lajmin e ka konfirmuar trajneri i xhudos, Driton Kuka, nëpërmjet një postimi në "Facebook", derisa konfirmon se xhudisti tjetër, Shpati Zekaj, është lënduar. "Arbër Kullashi i argjendtë në kategorinë 81 kilogramë. Në Lignano garuan juniorët U21 dhe Abi u stolis me medalje pas një dite me 7 luftëra gjithsej, nismë e mbarë e tij për këtë vit. Favoriti për medalje Shpati Zekaj erdh deri në gjysmëfinale, ku pësoi një lëndim dhe u desh t'i ndërpresë garat, shpresojmë që lëndimi të mos jetë i rëndë", ka shkruar Kuka. Më tutje, ai ka shkruar se Rios Kuka, kategoria 90 kg, shënoi dy fitore dhe arriti në çerekfinale dhe mandej pësoi humbje e, sipas Driton Kukës, ai ka mungesë përvojë në gara ndërkombëtare diç që sivjet do ë mundohet ta fitojë. "Selim Berisha e Arbër Nikqi fituan nga një fitore, mandej u eliminuan dhe mbetën pa plasman. Kosova nga kjo garë kthehet me tri medalje të të gjitha ngjyrave", ka shkruar Kuka. Kujtojmë se të shtunën në këtë garë Dardan Cena kishte rrëmbyer të artën, derisa Anes Veseli të bronztën.

### Drita fiton miqësoren ndaj skuadrës polake

Skuadra e Dritës e fitoi miqësoren ndaj FC Zagalabie Lubin (1-0), e cila u zhvillua në Antalia. Kjo ishte miqësorja e parë në Turqi për skuadrën nga Kosova. Në këtë takim u paraqitën pothuajse të gjithë lojtarët në përjashtim të Bunjamin Shabanit, Olti Mehmetit dhe Ardit Mustafës, të cilët kanë qenë me disa ngarkesa muskulore. Ndeshja e radhës, Drita, e zhvillon më 30 janar kundër Vorsklas nga Ukraina.

### Shënon Sadiku

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Sadiku, ka shënuar një gol të bukur në ndeshjen në mes të Malagas dhe Mirandes, e cila përfundoi me rezultat të barabartë 2-2. Sulmuesi nga Elbasani në minutën e 65-të kaloi skuadrën e tij në epërsi 2-1, por mysafirët nuk u dorëzuan dhe arritën ta barazojnë rezultatin në 2-2.

### Berisha shënon dy gola për Western Unitedin

Sulmuesi Besart Berisha po shkëlqen në elitën e futbollit australian. Futbollisti shqiptar shënoi dy gola, por nuk arriti ta shpëtojë nga humbja ekipin e tij Western United ndaj Adelaide Unitedit (3-4). Berisha shënoi dy golat e parë për ekipin e tij, në minutat 12 dhe 43, derisa arrin në kuotën e 11 golave pas 15 xhirove, që e bën atë lojtarin e tretë më efikas në ligë. Kjo ishte paraqitja e 200 e Berishës në kampionatin australian.

### Federata e Badmintonit e Kosovës pranohet në Asociacionin Ballkanik të Badmintonit

Federata e Badmintonit e Kosovës është pranuar me të drejta të plota në Asociacionin Ballkanik të Badmintonit, vendim ky është marrë të shtunën në Haskovo të Bullgarisë. Pro anëtarësimit të Kosovës votuan këto shtete Shqipëria, Bullgaria, Turqia, Rumania, Greqia, Maqedonia e Veriut, ndërsa Serbia mungoi. Pas votimit, presidenti i Asociacionit Ballkanik të Badmintonit, Puzant Kassabian, konstatoi se Federata e Badmintonit e Kosovës pa asnjë votë kundër është pranuar si anëtare fuqiplote e këtij Asociacioni. Federata e Badmintonit e Kosovës vitin e kaluar ishte pranuar edhe në Federatën Botërore të Badmintonit si dhe në atë evropiane.

## Gjilani përfundon përgatitjet në Turqi



Gjilan, 26 janar - Skuadra e Gjilanit i ka mbyllur përgatitjet parasezonale në Turqi. Përgatitjet e kësaj skuadre në Antalia zgjatën 10 ditë, ku brenda kësaj kohe ekipi kuq e bardh zhvilloi tri ndeshje miqësore. Fitore 1-0 regjistroi ndaj Neftchi Kochkor dhe Yenisey Krasonyarsk, kurse humbi 1-0 nga Çelik Zenica. Faza përgatitore, sipas shtabit teknik, rezultoi e suksesshme, duke parë formën e futbollistëve dhe punën e realizuar sipas planprogramit, ku vlen të ceket se gjatë kësaj kohe të punës intensive futbollistët e skuadrës, përveç formës së arritur pozitive, cilësohet se nuk kishte ndonjë lëndim të lojtarëve. "Të kënaqur me rezultatet e punës dhe me formën e arritur gjatë kësaj faze skuadra stërvitjet pritet t'i vijojë në qytetin e Gjilanit, kur kanë mbetur saktësisht edhe dy javë para ndeshjes hapëse, e cila do të jetë ajo kundër Drenicës, në Digitalb Kupën e Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.

# Kupa 'Nëna Terezë' bashkon skuadrat nga Kosova dhe Shqipëria

Prishtinë, 26 janar - Kupa "Nëna Terezë" pritet t'i bëjë bashkë ekipet e futbollit nga dy shtetet shqiptare, Shqipëria dhe nga Kosova. Kjo kupë shihet si alternativa e vetme për të pasur një kampionat mbarëshqiptar, si nga Federata e Futbollit të Shqipërisë (FShF), ashtu edhe nga Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), mirëpo për t'u realizuar një gjë e tillë, dy federatat duhet të marrin leje nga FIFA dhe UEFA. Tashmë dokumentacioni me projektin në fjalë është dorëzuar dhe dy federatat janë në pritje të një përgjigje pozitive në mënyrë që ky aktivitet të fillojë qysh nga sezoni 2020/21. Në këtë kupë parashihet të marrin pjesë të gjitha ekipet e Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës së Dytë të të dyja vendeve. Aktualisht kategoria superiore e Shqipërisë ka dhjetë ekipe dhe e Kosovës ka dymbëdhjetë. Kategoria e parë e Shqipërisë ka aktualisht 20 ekipe dhe kategoria e parë e Kosovës ka 16. Kategoria e dytë e Shqipërisë ka aktualisht 26 ekipe, ndërsa e Kosovës, 16 sosh. Në total pjesëmarrës në këtë kupë pritet të jenë rreth 102 ndeshje, ku do të zhvilloheshin më shumë se 200 ndeshje në total. Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, për "KosovaPress" është shprehur se në këtë kupë do të jenë të përfshira të gjitha klubet e futbollit si nga Shqipëria, ashtu edhe nga Kosova. "Sigurisht do të udhëhiqet nga një komision i përzier, por ajo që është me më rëndësi është që kjo kërkon kosto të veçantë. Të gjitha klubet do të jenë të përfshira, domethënë edhe Ligat e Treta, ligat regjionale do të luajnë, në Kupë vajtje-ardhje kështu që do të ishte shumë interesante të shkohet nga këtu në Gjirokastër… krejt magjia e këtij bashkëpunimi është që të jemi të sinqertë, që edhe klubet shqiptare të kuptojnë pak realitetin kosovar, të vijnë pak të njoftohen me popullatën, të ketë aty dashuri dhe miqësi ashtu siç është edhe emri 'Nëna Terezë', i këtij formati të kupës", ka thënë Salihu. "Ne do të ndihmojmë. Pikërisht për këtë arsye Duka dhe Ademi kanë potencuar se do të gjejnë sponsorë nga qeveria, federatat, në mënyrë që klubet mos t'i rëndojnë. Pra, esenca është që klubet ta shijojnë këtë format të ri të garave, jo që t'i ngarkojmë ato me këste shtesë", ka shtuar Salihu.



Sekretari i FFK-së bëri me dije se janë duke munduar që fituesi i kësaj kupe të marrë pjesë në garat evropiane. "Sa do të jetë kjo e realizueshme nuk e di, ndoshta nëse merremi vesh të dyja federatat të gjejmë një vend, por është me rëndësi që faktori financiar, që ekipi i parë, i dytë, i tretë ashtu siç vendosin të kenë një fitim, një shpërblim të majmë, kështu financiar, për çka do të interesoheshin pastaj klubet, sepse sistemit të kupës nuk i dihet kurrë", përfundoi Salihu.

Ndërkohë që drejtori sportiv i Flamurtarit, Arbnor Morina, e sheh këtë kupë si pozitive për klubet e Shqipërisë dhe të Kosovës. Ai theksoi se kosto financiare mund të jetë një pengesë për realizimin e suksesshëm të kësaj kupe. "Mendoj se është e mirë për arsye se rritet konkurrenca, klube ka më tepër, konkurrenca është më e madhe, mirëpo edhe dalin gjëra të tjera të cilat mund të jenë pengesë. Në radhë të parë është kosto financiare sepse udhëtimet do të jenë shumë më të gjata, do të kenë nevojë klubet të shkojnë një ditë ose dy para ndeshjes në qytetet respektive etj. Në përgjithësi nga ana sportive është një hap mjaft i madh, mjaft i qëlluar, edhe një hap i cili vetëm shkon në favor të futbollit", ka deklaruar Morina. "Mirëpo dalëngadalë ne duhet të mësohemi edhe me këtë ritëm, sepse unë shpesh e kam përdorur një fjalë, kur të pranohemi në UEFA më nuk luajmë ne me muzikën që e bëjmë ne, por luajmë me muzikën që e bën UEFA. Kështu që deshëm apo nuk deshëm ne duhet t'i përshtatemi këtij ritmi, duhet ta profesionalizojmë edhe më tepër, duhet ta rrisim fondin e lojtarëve sepse të luash në tre fronte nuk është lehtë, është shumë e vështirë, shumë e kushtueshme dhe shumë e kërkueshme, mirëpo mendoj se për futboll dhe për ngritjen e futbollistëve të të dyja anëve është shumë ide e qëlluar", ka deklaruar Morina.

Edhe analisti tjetër i futbollit, Muhamet Dragusha, e sheh këtë kompeticion si një ide mjaft të qëlluar dhe shpreson që kjo do të jetë një rrugë më shumë që ekipet e të dyja shteteve të paraqiten në Evropë. "Një ide e qëlluar për ta filluar bashkimin e futbollit mbarëkombëtar, mendoj se në qoftë se aprovohet nga FIFA do të ketë një interesim të madh pasi vendi i parë dërgon në UEFA, kështu që unë pajtohemi parimisht me këtë ide dhe besoj se mund të jetë rrugë e mirë dhe një mundësi më shumë për pjesëmarrje në garat evropiane", ka deklaruar Dragusha.

## SHKURT

### Rahoveci arrin fitoren e katërt në sezonin pranveror

KB Rahoveci ka shënuar fitoren e katërt në katër ndeshje të stinorit pranveror, duke mundur në udhëtim Trepçën me rezultat 82:92 (16:23, 21:25, 20:18, 25:26), në kuadër të javës së 22-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Te Trepça më të dalluarit ishin Dj Hanes me 33 pikë e gjashtë kërcime dhe Alante Fenner me 17 pikë e nëntë kërcime, kurse te Rahoveci më të mirët ishin Alban Veseli me 25 pikë e katër kërcime dhe Darell Davis me 22 pikë e gjashtë kërcime. Trepça ka katër fitore dhe 15 humbje, kurse Rahoveci 15 fitore dhe pesë humbje. Ndërsa Ponte Prizreni ka mundur në udhëtim Lipjanin me rezultat 77:97 (19:24, 19:23, 20:29, 19:21).

### Federeri në çerekfinale të Australian Openit

Roger Federeri ka kaluar në çerekfinale të Australian Openit pas fitores me rikthim kundër Marton Fucsovics në rundin e katërt të dielën në Melbourne. Gjashtë herë kampioni i Australian Open e mundi hungarezin 3 me 1 me sete, 4:6, 6:1, 6:2, 6:2. 38-vjeçari zviceran do të përballet me amerikanin Tennys Sandgren në rrethin e tetë më të mirëve të martën. Pasi e humbi setin e parë, Federeri ishte i pandalshëm duke i fituar me lehtësi tri setet e radhës. "E nisa mirë setin e dytë dhe nga aty gjërat u lehtësuan për mua", ka thënë Federeri.

### Marotta: Nuk kemi çka të fshihemi, Erikseni vjen së shpejti

Drejtori i Interit, Beppe Marotta, shpreson se marrëveshja të përfundojë sa më shpejt që është e mundur për transferimin e Christian Eriksen. Raportet e fundit sugjerojnë se një marrëveshje do të bëhet vetëm për 20 milionë, duke përfshirë bonuset dhe testet mjekësore janë caktuar për të hënën ose të martën. "Ne nuk do të fshihemi, ju të gjithë e dini se kemi negociuar me Tottenhamin për disa kohë", ka thënë Marotta. "Kontrata e tij do të skadojë më 30 qershor, kështu që të drejtat e vetme për të cilat ne po diskutojmë janë për ato gjashtë muaj. Ne jemi optimistë dhe shpresojmë që marrëveshja të përfundojë sa më shpejt që është e mundur, veçanërisht pasi afati i transferimeve mbyllet të premten", ka deklaruar drejtori i Interit.

### Milani kërkon 30 milionë euro për Piatekun

Krzysztof Piatek është në shitje këtë afat kalimtar, por vetëm për çmimin e kërkuar nga Milani. Sulmuesi polak nuk ka gjetur hapësirat e nevojshme këtë sezon te "Rossonerët" dhe hapësirat janë minimizuar edhe më shumë me ardhjen e Zlatan Ibrahimoviqit. Piatek po kërkohet shumë nga klubet evropiane, sidomos anglez. Tottenham Hotspur, Crystal Palace, Newcastle në Ligën Premierë dhe Barcelona në La Liga janë klubet që kanë shprehur më shumë interesim. Megjithatë, sipas mediumit italian "Calciomercato", Milani kërkon 30 milionë euro për yllin polak.

### Bale, afër rikthimit në Tottenham

Ylli i Real Madridit, Gareth Bale, mund të bëjë një rikthim të befasishëm te Tottenham Hotspur. Pak ditë pasi ishte raportuar se Bale ua ka bërë të ditur drejtuesve të Real Madridit se nuk largohet pa skaduar kontrata, uellsiani po lidhet me skuadrën e Tottenham Hotspurit. "Daily Express" raporton se Tottenhami ka hapur bisedimet për nënshkrimin e Gareth Bale nga Real Madridi. Londinezët duan ta finalizojnë operacionin gjatë këtij muaji. Bale pëlqehet shumë edhe nga Jose Mourinho, ky i fundit që, gjithashtu, po insiston për një finalizim të marrëveshjes. Uellsiani ka një pagë prej 650 mijë funteve në javë te Real Madridi. Paga mund të jetë problemi kryesor i "Spurs"-it për transferimin e Bales.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar më: Primljeno: 24.01 2020 | | |
|---|---|---|
| Njësia Jedinica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 10-345- | 4756 | |

Republika e Kosovës /Republika kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit / Opština Lipjan / Municipality of Lipjan

Në bazë të neneve 5,6,7 dhe 12 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019, nenit 1 të Rregullores Nr.15-345-70953 të datës 31.10.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjeteve taksi 15Nr.011-29428 e datës 02.05.2019 dhe Vendimit të Kryetarit 1Nr.345-4426 të datës 22.01.2020, Drejtorati për Shërbime Publike shpallë :

## NJOFTIM PUBLIK

Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete Taksi në Komunën e Lipjanit

Operatorët auto taksi duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve me automjete taksi.
- Të kenë selinë e biznesit në territorin e Komunës së Lipjanit
- Personat fizik të kenë në pronësi automjetin, ndërsa personat juridik të kenë në pronësi së paku 3 automjete.
- Automjeti duhet të jetë i regjistruar me 5 ulëse (4+1) dhe së paku 4 dyer ( nuk pranohet homologimi ose ndryshimi i ulëseve të automjetit)
- Ngjyra e automjeteve taksi mund të jenë të ndryshme me kusht që automjetit ti vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardh e zi sipas standardeve duke përjashtuar automjetet taksi që operojnë në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" të cilat duhet të jenë të ngjyrosura vetëm me ngjyrën e bardhë.
- Drejtuesit e automjeteve të posedojnë patentë shoferin për kategorinë "B" dhe së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa të pënësuarit te personi juridik edhe kontratën e punës.
- Operatorët të cilët operojnë auto taksi në qytetin e Lipjanit duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2000 ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2003.
- Përparësi për tu pajisur me licencë në kushte të barabarta do të kenë operatorët të cilët kanë ushtruar veprimtarinë auto taksi.
- Automjetet të cilat e bëjnë djegien me gas nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë auto taksi.
- Të posedojë taksimetrin e vendosur në automjet në gjendje të rregullt, i bazhdaruar nga organi kopetent.
- Të ketë të vendosur mbi kabinë paralel me erëmbrojtësin tabelën me dimenzione standarde e paisur për ndriçim natën me shenjën "TAXI"
- Të posedojë aparatin për fikjen e zjarrit.

Operatorët të cilët aplikojnë për marrjen e licencës, aplikacionit duhet ti bashkangjitet dokumentacionin, si vijon:

- Certifikatën mbi regjistrimin e biznesit
- Informatat mbi të dhënat e biznesit
- Fotokopjen e Certifikatës së regjistrimit të automjetit
- Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e patent shoferit për kategorinë "B" ndërsa për të punësuarit edhe kopjen e kontratës së punës
- Vërtetimi nga Policia mbi të kaluarën kriminale të operatorit dhe vozitësit te personat juridik.

Aplikacionet merren në zyrën e Drejtoratit për Shërbime Publike.

Afati i aplikimit është 15 ditë prej datës së publikimit.

Nr. 10-345-4756

Lipjan, datë 24.01.2020

Drejtori i DSHP-së
z. Rasim Hasani

# >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ismet Rexhep Ademi, shpall të pavlefshme Certifikatën për kryerjen e arsimit dhe aftësimit profesional SHMLP "Anton Çetta" Skenderaj ( nr. Vendimit 26-3-021/1).

▶ Nexhmije Xhinovci , shpall të pavlefshme dëftesën e (kl. I -V) SHF "Elena Xhika" Makermal.

▶ "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mije ) në 5000 Euro.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

***Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister***

***Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo***

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit te te Dhënave te Fituara me Përpunime te Veçanta te Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:

## Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

| | |
|---|---|
| Emri i Institucionit | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| Titulli i pozitës(ave): | Koordinator, Mbikëqyrës, Regjistrues dhe Staf mbështetës për azhurnimin e Qarqeve Regjistruese |
| Numri i referencës | ASK-DMTI 001 |
| Raporton te: | Divizioni i IT&GIS-it |
| Lloji i kontratës: | Marrëveshje për Shërbime të Veçanta–(MSHV) |
| Kohëzgjatja e kontratës: | Deri në 6 muaj |
| Orari i punës: | I plotë |
| Numri i stafit të kërkuar: | 5 Koordinator, 2 Persona staf mbështetës, 12 Mbikëqyrës dhe 50 Regjistrues |

**Detyrat dhe përgjegjësit për Koordinator (5)**

- Koordinimi i punëve me mbikëqyrësit për ndarjen e qarqeve regjistruese.
- Përgatitja e të gjitha instrumenteve të nevojshme për Azhurnimin e Qarqeve regjistruese (Hartat, materialet e tjera për trajnime etj.).
- Regjistrimi dhe kontrolla e punës së intervistuesve dhe mbikëqyrësve në sistem nëpërmjet Survey Solution, nxjerrja e raporteve XLS * të konvertuara nëpërmjet databazave dhe krahasimi me hartat fizike me qëllim të nxjerrjes së të dhënave sa më cilësore.
- Koordinimi i takimeve për mbikëqyrësit dhe regjistruesit në qarqet e përziera me serb dhe Shqiptarë dhe mbikëqyrja e mbarëvajtjes së procesit nga afër tek qarqet e përziera.
- Nxjerrja e variablave dhe pastrimi i të dhënave nga fushat e zbrazëta, nxjerrja e të dhënave të pastra të azhurnuara në terren dhe lidhja me kontrollin fizik .
- Freskimi i Kornizës se mostrës me të dhënat nga Azhurnimi i Qarqeve regjistrues (I nevojshëm për të gjitha hulumtimet statistikore dhe organizimin e logjistikës së Regjistrimit Pilot dhe të përgjithshme).
- Mirëmbajtja dhe monitorimi i planeve të projektit te Azhurnimit të Qarqeve Regjistrues,
- Kontrollimi i punës së mbikëqyrësve në lidhje me kualitetin e të dhënave të pranuara.
- Kontrollimi i detajuar i qarqeve për të shmangur numrat e përsëritur të objekteve ne Survey Solution, kontrollimi i renditjes së saktë të numrave rritës si dhe evidentimi i çdo kodi brenda QR.
- Përpilimi Raporteve për kthim tek mbikëqyrësit dhe regjistruesit për përmirësim në teren dhe kthimi përsëri në qendër për arkiv.
- Bënë digjitalizimin e objekteve nga të gjeturat nga terreni (gjendja sipas vitit 2020);
- Kodifikimin e objekteve në databazën e GIS-it sipas të gjitha niveleve hapësinore
- Përgatit hartat e Qarqeve regjistruese dhe hartat në nivel të qytetit për nevoja të azhurnimit të Qarqeve regjistruese dhe të regjistrimit të popullsisë,
- Përgatit të dhënat atributive/tabelare për lidhjen e tyre në formatin GIS
- Koordinojnë aktivitet me Komisionet komunale për Pilot Regjistrimin
- Përgatit raporte javore dhe mujore për udhëheqësin e grupit punues.

**Përgatitja shkollore dhe përvoja:**

- Të kenë përfunduar studimet universitare;
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopeve /tabletave);
- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë bashkëpunuar me ASK në projektet e ngjashme me metodën CAPI.

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jenë të gatshëm të punojë me orarë fleksibil;
- Aftësitë kompjuterike, Word, Excel, GIS, Survey Solution internet etj. janë të nevojshme;

**Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit mbështetës (2)**

- Marrin pjesë në trajnime për procesin e azhurnimit të Hartave të Qarqeve Regjistruese;
- Bëjnë kompletimin e dosjeve për pjesëmarrësit në trajnim;
- Printojnë hartat dhe materialet e tjera të nevojshme për azhurnimin e Qarqeve Regjistruese.
- Shpërndajnë materialet e nevojshme për listim tek mbikëqyrësit;
- Pranojnë materialet nga mbikëqyrësi dhe të njëjtat i verifikon në sistemin Survey Solution dhe i arkivon në ASK;
- Vizitat në teren me raste për verifikim të qarqeve azhurnuese;
- Bëjnë raporte javore dhe mujore për ASK;
- Të tjera sipas nevojave të azhurnimit;

**Përgatitja shkollore dhe përvoja:**

- Të kenë të kryer Fakultetin;
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopeve/tabletave);
- Të kenë përvojë në koordinim të punëve në teren dhe në zyre;
- Përparësi kanë kandidatet të cilët kanë bashkëpunuar me ASK-n në projektet e ngjashme me metodën CAPI.

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi shumë të mira për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira organizative ;
- Njohja e aplikacioneve të cilat shërbejnë për printim/plotim të hartave;
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, Sistemi Survey Solution, internet etj., janë të nevojshme;

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrësve (12)**

- Marrin pjesë në trajnime për procesin e listimit e ekonomive familjare dhe azhurnimin e hartave;
- Marrin pjesë në punën praktike në terren;
- Bëjnë shpërndarjen e materialeve të nevojshme për listim tek regjistruesit;
- Mbajnë kontakte ditore me regjistruesit për të cilët është mbikëqyrës;
- Monitoron punën në teren lidhur me listimin e ekonomive familjare dhe azhurnimin e Qarqeve Regjistruese sipas udhëzimeve;
- Ndihmon në rastet të veçanta listuesit/azhurnuesit në identifikimin e Qarkut Regjistrues;
- Verifikon te dhënat paraprake me te dhënat e marrura nga terreni
- Kontrollon materialin në aspektin e cilësisë dhe gjithë përfshirjes si dhe bene aprovimin e tyre;
- Përgatit raporte ditore dhe javore për ASK;
- Në rastin e refuzimeve brenda një Qarku Regjistrues, mbikëqyrësi duhet të bëjë përpjekje për gjetjen e mënyrës për marrjen e informatave;
- Mbledhin dhe kontrollojnë materialin nga listuesit / azhurnuesit dhe të njëjtin e dorëzon në ASK.

**Përgatitja shkollore dhe përvoja:**

- Të kenë të përfunduar Fakultetin;
- Të kenë përvojë në punë të azhurnimit të hartave dhe intervistime të ngjashme;
- Të kenë përvojë menaxheriale.
- Të ketë patent shofer.

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jenë të gatshëm të punojë me orarë fleksibil;
- Aftësitë kompjuterike, Word, Excel, internet etj. janë të nevojshme;
- Të jenë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet aktiviteti i azhurnimit të Qarqeve Regjistruese.

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Regjistruesve (50)**

- Marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike hartografike dhe demografike të anëtarëve të ekonomisë familjare)
- Të jetë i përgatitur për të praktikuar punën në terren bazuar në udhëzimet për Azhurnimin e Qarqeve Regjistruese;
- Zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për azhurnimin e Qarqeve Regjistruese me metodologjinë CAPI (tabletë);
- Bëjnë identifikimin e të gjithë ekonomive familjare duke intervistuar Kryefamiljarin apo ndonjë anëtar të ekonomisë familjare (në moshë madhore);
- Para largimit nga ekonomia familjare të bëjnë kontrollimin e pyetësorit elektronik të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Rishqyrtimi për të intervistuar të anketuarit të cilët nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Përdorimi i adresave dhe hartave për Qarqeve Regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara;
- Të njoftojë mbikëqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkoni ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flet ai komunitet;

- Të përfundojë azhurnimin e Qarqeve Regjistruese me të dhëna për ekonomitë familjare brenda afatit;
- Të bëjë raportime ditore, javore dhe mujore lidhur me intervistat e realizuara;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuara në familjet e anketuara si sekret zyrtar;
- Pas përfundimit të punës në terren, të gjitha pajisjet e pranuara nga ASK (laptopat apo tabletat) është i obliguar ti kthej në ASK.

**Përgatitja shkollore/përvoja:**

- Të kenë të kryer shkollën e mesme;
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopeve/tabletave);
- Të kenë përvojë pune në terren;
- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;
- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marre pjesë së paku në një anketë me metodën CAPI.

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësitë kompjuterike, Word, Excel, internet etj., janë të nevojshme;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë duke përfshirë edhe vikendet;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku kërkohet të zhvillohet azhurnimi i Qarqeve Regjistruese.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.**

Numri i Mbikëqyrësve sipas regjionit:

| Regjioni | Mbikëqyrës total |
|---|---|
| Gjakovë | 1 |
| Prizren | 1 |
| Gjilan | 1 |
| Ferizaj | 1 |
| Prishtinë | 4 (1 serb) |
| Mitrovicë | 3 (2 serb) |
| Pejë | 1 |
| **Gjithsej** | **12** |

**Numri i Regjistruesve sipas etnitetit dhe regjionit**:

| Regjioni | Nr Regjistrueseve Shqiptar | Nr i regjistrueseve sipas etnicitetit | Total |
|---|---|---|---|
| Gjakovë | 4 | | 4 |
| Gjilan | 4 | 1 - serb | 5 |
| Ferizaj | 3 | 1 - serb | 4 |
| Prishtinë | 12 | 2 - serb | 14 |
| Mitrovicë | 4 | 7 - serb | 11 |
| Pejë | 6 | | 6 |
| Prizren | 5 | 1- serb | 6 |
| **Gjithsej** | **38** | **12** | **50** |

**Paraqitja e kërkesave:**
Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën: http://ask.rks-gov.net/
Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave te Kosovës, Rr,"Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:**

CV, kopja e letërnjoftimit, diploma e shkollës së mesme ndërsa për Mbikëqyrës, Koordinatore dhe staf mbështetës Fakultetit), (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen intervistës me gojë.
Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 154 prej orës 08:00 – 16:00.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
***Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister***
***Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo***

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

## Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

| | |
|---|---|
| Naziv institucije: | Agencija za Statistiku Kosova |
| Naziv pozicije(a): | Koordinator, Supervisor, Popisivač i pomoćno Osoblje za ažuriranje Popisnih Krugova |
| Referentni broj: | ASK-DMTI 001 |
| Izveštava: | Divizija IT i GIS-a |
| Vrsta ugovora: | Sporazum za Posebne Usluge-(SPU) |
| Trajanje ugovora: | Do 6 meseci |
| Radno vreme: | Puno |
| Broj izvršilaca: | 5 Koordinatora, 2 Osobe (pomoćno osoblje), 12 Supervizora i 50 Popisivača |

**Zadaci i odgovornosti Koordinatora (5):**

- Koordiniranje rada sa supervizorima za podelu popisnih krugova;
- Priprema svih potrebnih instrumenata za ažuriranje popisnih krugova (mapa, drugog materijala za obuku itd.
- -Unošenje i kontrola rada anketara i supervizora u sistemu putem Survey Solution-a, izrada XLS * izveštaja pretvaranih kroz baze podataka i upoređivanje sa fizičkim mapama radi dobivanja kvalitativnih podataka;
- Koordinacija sastanaka za supervizore i popisivače u mešovitim popisnim krugovima sa Srbima i Albanacima i pažljivo praćenje napretka procesa u mešovitim krugovima;
- Dobijanje promenljivih i čišćenje podataka iz praznih polja, dobijanje čišćenih ažuriranih podataka sa terena i povezivanje sa fizičkom kontrolom;
- Ažuriranje uzorka okvira sa podacima iz Ažuriranja Popisnih Krugova (Potreban za sva statistička istraživanja i organizaciju logistike probnog i opšteg popisa);
- Održavanje i praćenje planova projekta ažuriranja Popisnih Krugova;
- Detaljna kontrola krugova kako bi se izbegli duplicirani brojevi objekata u Survey Solution, kontrola ispravnog redosleda rastućih brojeva i identificiranje svakog koda unutar PK-a.
- Kontrola rada supervizora u pogledu kvaliteta primljenih podataka.
- Sastavljanje izveštaja koji treba biti vraćeni supervizorima i popisivačima za korekciju na terenu i ponovo vraćeni natrag u centar radi arhiviranja;
- Digitalizacija objekata iz terenskih nalaza (situacija u 2020.godini);
- Kodiranje objekata u GIS bazi podataka prema svim prostornim nivoima;
- Priprema mape popisnih krugova i mape na nivou grada za potrebe ažuriranja Popisnih krugova i Popisa stanovništva,
- Priprema atributivnih / tabelarnih podataka za njihovo povezivanje u GIS formatu;
- Koordinira aktivnosti sa Opštinskim Komisijama za Probni Popis;
- Priprema nedeljne i mesečne izveštaje za vođu radne grupe.

**Školska sprema i iskustvo:**

- Završene univerzitetske studije;
- Iskustvo u primeni informacione tehnologije (laptopa/tablet računara);
- Prednost imaju osobe koje su sarađivale sa ASK-om u sličnim projektima, CAPI metodom.

**Kompetencije i veštine:**

- Veoma dobre veštine komunicaranja i saradnje;
- Spreman/na za temski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije( korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Dobre organizacijske sposobnosti i, po potrebi, spremnost za fleksibilan rad;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, GIS, Survey Solution, internet je potrebno.

**Zadaci i odgovornosti Pomoćnog osoblja (2):**

- Učestvuje u obuci o procesu Ažuriranja Mapa Popisnih Krugova;
- Kompletira personalni dosije učesnika u obuci;
- Štampanje mapa i drugog materijal potrebnog za ažuriranje Popisnih Krugova.

- Distribuira potrebni materijal za listiranje kod Supervizora;
- Prima materijale od supervizora, primljeni materijal verifikiuje u sistemu Survey Solution i arhivira u ASK-u;
- Povremene posete na terenu radi proveravanja ažuriranja popisnih krugova
- Sastavlja nedeljne i mesečne izveštaje za ASK;
- Ostalo prema potrebama ažuriranja.

**Školska sprema i iskustvo:**

- Završen fakultet;
- Iskustvo u primeni informacione tehnologije (laptopa/tablet računara);
- Iskustvo u koordinaciji terenskih i kancelarijskih poslova;
- Prednost imaju osobe koje su sarađivale sa ASK-om u sličnim projektima, CAPI metodom.

**Kompetencije i veštine:**

- Veoma dobre veštine komunicaranja i saradnje;
- Spreman/na za timski rad;
- Dobre organizacione veštine;
- Poznavanje aplikacija koje se koriste za štampanje/plotiranje mapa;
- Potrebno je poznavanje rada na računaru word, excel, sistem Survey Solution, internet itd

**Zadaci i odgovornosti Supervizora (12):**

- Učestvuje u obuci o procesu listiranja domaćinstava i ažuriranja mapa;
- Učestvuje u praktičnom radu na terenu;
- Distribuira potrebni materijal za listiranje kod Popisivača;
- Održava svakodnevne kontakte sa svojim Popisivačima;
- Prati rad na terenu – Listiranje domaćinstava i ažuriranje PK-a prema uputstvima;
- Pomaže u posebnim slučajevima Popisivaće/Ažurante za identifikaciju PK-a;
- Proverava preliminarne podatke sa podacima dobijenim sa terena;
- Vrši kontrolu materijala u pogledu kvaliteta i sveobuhvatnosti i njihovo odobrenje;
- Izrađuje dnevne i nedeljne izveštaje za ASK;
- U slučaju većih odbijanja unutar jednog PK-a, Supervizor treba da se potrudi da pronađe način za dobijanje informacija;
- Preuzima materijal od Popisivaća /Ažuranta, kontroliše i dostavlja taj materijal u ASK.

**Školska sprema i iskustvo:**

- Završeni fakultet;
- Iskustvo u ažuriranju mapa i sličnim intervjuima;
- Iskustvo u upravljanju.

**Kompetencije i veštine:**

- Veoma dobre veštine komunicaranja i saradnje;
- Spreman/na za temski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije( korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Dobre organizacijske sposobnosti i, po potrebi, spremnost za fleksibilan rad;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedeno ažuriranje Popisnih Krugova.

**Zadaci i odgovornosti Popisivača (50):**

- Učestvuje u obukama i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (Osnovnim kartografskim i demografskim podacima o članovima domaćinstva);
- Bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za Ažuriranje Popisnih Krugova;
- Prikuplja podatke za ažuriranje Popisnih Krugova metodom CAPI (tablet računara).
- Vrši identifikaciju svih domaćinstva intervjuisanjem Nosioca domaćinstva ili nekog člana domaćinstva (punoletna osoba);
- Pre napuštanja domaćinstva kontroliše popunjeni upitnik da se osigura da su popunjeni svi odgovori na pitanja iz upitnika i sva uputstva praćena;
- Razmotri mogućnost intervjuisanja domaćinstva koje nije bilo moguće intervjuisati tokom prve posete;
- Koristi adrese i mape za određene popisne krugove i domaćinstva;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik;
- Završava Ažuriranje PK-a sa podacima o domaćinstvima u propisanom roku;
- Izveštava dnevno, nedeljno i mesečno o obavljenim intervjuima;
- Sve dobijene podatke o anketiranim domaćinstvima treba da čuva kao službenu tajnu;
- Vrati materijal i opremu primljenu od ASK-a (laptop ili tablet računar) nakon završetka rada na terenu.

**Školska sprema/ iskustvo:**

- Završena srednja školu;
- Iskustvo u upotrebi informacionih tehnologija (laptopa/tablet računara);
- Iskustvo rada na terenu;
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili koji su učestvovali u najmanje jednoj anketi sprovedenoj CAPI metodom .

**Kompetencije i veštine:**

- Veoma dobre veštine komunicaranja i saradnje;
- Spreman/na za timski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije ( korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd;
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedeno ažuriranje Popisnih Krugova..

**Uslovi učešća na konkursu:**

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18,godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb-stranici ASK-a.**

**Broj Supervizora po regionima:**

| Regioni | Ukupno supervizora |
|---|---|
| Đakovica | 1 |
| Prizren | 1 |
| Gnjilane | 1 |
| Uroševac | 1 |
| Priština | 4 (1 srbin) |
| Mitrovica | 3 (2 srba) |
| Peć | 1 |
| **Ukupno** | **12** |

**Broj Popisivača prema etničkoj pripadnosti i regionima:**

| **Regioni** | Broj Popisivača-Albanaca | Broj Popisivača prema etničkoj pripadnosti | Ukupno |
|---|---|---|---|
| Đakovica | 4 | | 4 |
| Gnjilane | 4 | 1 - srbin | 5 |
| Uroševac | 3 | 1 - srbin | 4 |
| Priština | 12 | 2 - srba | 14 |
| Mitrovica | 4 | 7 - srba | 11 |
| Peć | 6 | | 6 |
| Prizren | 5 | 1- srbin | 6 |
| **Ukupno** | **38** | **12** | **50** |

**Podnošenje prijava**:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: http://ask.rks-gov.net/. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova , Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

**Uz aplikaciju potrebno je priložiti:** CV, Kopiju lične karte, diplomu o završenoj srednjoj školi, dok za Supervizora, Koordinatora i Pomoćno Oosblje diplomu fakulteta fakulteta (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka *roka neće* biti *prihvaćene.*

Zbog velikog broja primljenih prijava,samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 ili 038-200 31 154 od 08:00 – 16: 00 časova.

Më 25 janar u bënë tetë vite, që kur nga ne u nda fizikisht nëna, vjehrra, gjyshja, stërgjyshja jonë e dashur:

# Qamile THAÇI-BYTYÇI

(01.01. 1936-25.01.2012)



**TETË (8) VITE PA TY, NËNA QAMILE!**

Sado që kalojnë vitet, në familjen tonë ndihet shumë mungesa jote, më e dashura jonë, Nëna Qamë, gjyshja jonë e madhe! Mbetesh edhe rreze delli, plot ngrohtësi e shkëlqim, rrugë mbara e shtigjeve të jetës sonë! Fjalët tua, plotë mirësi, më të ëmbëla se çdo gjë, një buzëqeshje, përkëdhelëse, gjithmonë me të qeshura, kënaqnin djemtë, nipërit, mbesat, stërnipër, stërmbesa! Nëna Qamile na mungon... Koha dhe dashuria, shërojnë çdo plagë! Nëna Qamile, GJYSHE, ne jemi mirë! Vetëm se, për ty kemi përherë mall!

**Gjithnjë me mall e dashuri, e përkujtojnë, djemtë, rejat, nipërit, mbesat, stërnipërit, stërmbesat nga Shkoza, Prishtina dhe Gjermania**

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo” dega në Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 70560534 me nr. fiskal: 600530093 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo”, organak na Kosovo, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom 70560534 me nr fiskal: 600530093 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Supreme Foodservice GMBH Branch Office Kosovo”, branch in Kosovo, has come to the decision to quit its business 70560534 nr. fiskal: 600530093, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues